

## **Gjykimet për krime të luftës dhe vepra penale të motivuara etnikisht dhe politikisht në vendet e ish Jugosllavisë**

Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) gjatë vitit 2008 i ka monitoruar të gjitha gjykimet e zhvilluara në Serbi për krime të luftës, vrasje dhe vepra tjera penale që kanë ndodhur gjatë konflikteve të armatosura, të gjitha gjykimet e mbajtura në Kosovë për krime të luftës dhe vepra penale të motivuara etnikisht apo politikisht, si dhe disa prej gjykimeve të zgjedhura për krime të luftës në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, në kuadër të bashkëpunimit rajonal për përcjelljen e gjykimeve për krime të luftës pranë gjykatave nacionale.

### **1 Gjykimet në Serbi për krime të luftës dhe vepra tjera penale të motivuara etnikisht**

Gjykimet për krime të luftës në Serbi janë zhvilluar para kolegjit gjykues për krime të luftës në Gjykatën e Qarkut të Beogradit dhe Pozharevcit, kurse në Gjykatat e Qarkut të Nishit dhe Novi Sadit janë gjykuar rastet e vrasjeve të motivuara etnikisht gjatë konflikteve të armatosura në ish Jugosllavi. FDH-ja u ka siguruar palëve të dëmtuara përfaqësues të autorizuar gjatë gjykimeve në rastin *Bytyqi, Suhareka, Ovçara, Lovas, Podujeva II, Zvorniku I dhe II, Paksheci dhe Emini*. Monitoruesit e FDH-së e kanë përcjellë ecurinë e seancave kryesore të gjykimeve për krime të luftës në rastin: *Kolona e Tuzllës, Zvorniku III, Banski Kovačevac, Fusha e Grubishinës, Slunji, Skorpionët II dhe Rahoveci*.

Gjykimet e rasteve *Suhareka, Zvorniku I dhe II, Bytyqi dhe Lovas* janë monitoruar nga familjet e viktimave. Falë ndihmës financiare dhe përkrahjes së USAID-it dhe fondacionit të OAK-së, FDH-ja u mundësoi anëtarëve të familjeve të viktimave ardhjen në Beograd për t'i përcjellë gjykimet. Njëzet anëtarë të familjeve të viktimave kanë qëndruar për çdo muaj në Beograd dhe kanë përcjellë gjykimet e përmendura për krime të luftës. Pas 17 shkurtit të vitit 2008, familjarët e viktimave nga Kosova nuk kanë ardhur më në Beograd për shkak të frikës dhe situatës së pakëndshme të krijuar pas shpalljes së pavarësisë, por kjo ka ndryshuar në qershor kur familjarët e viktimave të vrasjeve në Suharekë/Suva Reka filluan ta përcjellin gjykimin përsëri.

Edhe këtë vit, sikurse gjatë viteve paraprake, FDH-ja ka vazhduar t'i inkurajojë dëshmitarët dhe të dëmtuarit nga shtetet tjera që të marrin pjesë në gjykimet para trupit gjykues për krime të luftës. Ajo ka siguruar pjesëmarrjen e gjithë të dëmtuarve në rastin *Podujeva II* (gjithsej gjashtë) dhe tre të dëmtuarve e dy dëshmitarëve nga Kosova në rastin e Suharekës/Suva Reka. FDH-ja është kujdesur për sigurimin e masave mbrojtëse për dëshmitarët/të dëmtuarit, dhe për këtë qëllim ka bashkëpunuar në mënyrë efikase dhe profesionale me Njësinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të MPB-së së Serbisë.

Në gjysmën e dytë të vitit 2008, Prokuroria për krime të luftës ka pranuar dy kallëzime penale nga FDH-ja për krimet e luftës të kryera në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë. Deri në fund të vitit, Prokuroria nuk ka paraqitur kërkesë për kryerjen e hetimeve.

Monitorimi i kujdesshëm i gjykimeve për krime të luftës tregon disa karakteristika të rëndësishme:

**i.** Gjykata Supreme e Serbisë po vazhdon me praktikën e shfuqizimit të aktgjykimeve dënuese për krime të luftës për të cilat është vendosur në shkallën e parë, duke i ulur dukshëm dënimet e shqiptuara dhe duke i vërtetuar aktgjykimet që lirojnë të akuzuarit, që le të dyshohet se këto vendime kanë prapavijë politike.

Gjykimi i përsëritur kundër të akuzuarve për rastin *Ovçara* po vazhdon për më shumë se dy vite, ku gjykata po vepron në bazë të vërejtjeve të shumta të bëra nga Gjykata Supreme, të cilat nuk janë të bazuara në shkeljen e ligjit apo në mos vërtetimin e saktë apo të plotë të gjendjes faktike. Në vitin 2008, Gjykata Supreme ia uli dënimin pjesëtarit të njësisë *Skorpionët*, Branislav Mediqit, nga 20 në 15 vite burgim, edhe pse ai ishte dënuar për vrasjen e më së paku dy myslimanëve dhe pjesëmarrjen aktive në likuidimin e gjashtë robërve. Gjykata Supreme vërtetoi vendimin për lirim të pjesëtarit të *Skorpionëve*, Aleksandar Vukov, përkundër faktit se në bazë të dëshmive të prezantuara gjatë procedurës është treguar pa dyshime përgjegjësia e tij penale. Duke pasur parasysh se Gjykata Supreme është instanca më e lartë vendimmarrëse në lidhje me ankesën e prokurorit për përgjegjësinë e të akuzuarve dhe fakti se për të gjitha ankesat vendos vetëm një trup gjykues, i përbërë gjithmonë nga të njëjtit gjykatës, tregon se ekziston rreziku real që vendimet përfundimtare gjyqësore të merren në mënyrë arbitrare;

**ii.** Gjykimet zgjasin tepër gjatë, veçanërisht për shkak të praktikës që ndjek Gjykata Supreme për shfuqizimin e vendimeve të drejta të gjykatave të shkallës së parë, për arsye politike. Çdo gjykim në shkallën e parë zgjat më së paku dy vite. Një nga arsyet objektive për zgjatjen kaq shumë të procedurës, është fakti se dëshmitarët dhe të dëmtuarit nga shtetet tjera nuk janë të detyruar t'u përgjigjen thirrjeve të kolegjit për krime të luftës për të dëshmuar në gjyq, prandaj edhe nuk mund të sillen me forcë në rast të mosparaqitjes, siç veprohet me shtetasit e Serbisë. Zgjatja e tepërt e procedurës vjen edhe për shkak se në kolegjin për krime të luftës gjykojnë vetëm pesë gjykatës, që nuk mjaftojnë as për formimin e dy trupave gjykues.

**iii.** Pjesëmarrësit në procedurë [kolegji gjykues, prokurori, përfaqësuesit e autorizuar të personave të dëmtuar, mbrojtësit e të akuzuarve dhe të akuzuarit] shpesh bëjnë pyetje që nuk kanë lidhje fare me aktakuzën, apo janë jashtë kontekstit në të cilin janë zhvilluar krimet e përfshira në aktakuzë. Mbrojtësit e të akuzuarve në të gjitha lëndët insistojnë në informatat që kanë të bëjnë me seancën dëgjimore gjatë procedurës paraprake, informata nga jeta personale, private dhe familjare, si edhe për çështje që kanë implikime politike, nacionale dhe patriotike.

**v.** Duke shfuqizuar vendimin për rastin *Ovçara*, Gjykata Supreme ka kërkuar ekspertizë psikiatrike për dëshmitarin, duke futur në këtë mënyrë në praktikën gjyqësore prova që

deri atëherë nuk janë përdorur. Në kundërshtim me rregullat e procedurës ligjore, sipas të cilave gjykata është kompetente vetëm të vlerësojë dëshminë e dëshmitarit, Gjykata Supreme e ka vënë psikiatrin në rolin e arbitrit të çështjeve krejtësisht juridike. Kolegji gjykues në rastin e Suharekës, duke respektuar autoritetin dhe qëndrimin e Gjykatës Supreme, ka kërkuar ekspertizë psikiatrike për pjesën dërmuese të dëshmitarëve që ishin të gatshëm të thonë para gjykatës gjithë atë që kanë parë dhe dëgjuar për ngjarjet që ishin objekt i aktakuzës. Njëqind dëshmitarë tjerë që u morën në pyetje nga gjykata, thanë se nuk dinë asgjë për ngjarjen për të cilën po gjykohen të akuzuarit, edhe pse bëhet fjalë për rastin ku janë vrarë 49 njerëz, në qendër të një qyteze shumë të vogël, në afërsi të institucioneve ku ata punonin dhe atë në mes të ditës [ora 12:00]. Për asnjë nga këta dëshmitarë gjykata nuk caktoi ekzaminim psikiatrik, kurse ekzaminohen dëshmitarët e vetëm që ishin të gatshëm të tregojnë atë që kanë parë dhe dëgjuar. Kjo është absurde dhe e pakuptimtë.

## **1.1. Gjykimet për krime të luftës dhe krime të motivuara etnikisht, në të cilat të dëmtuarit kanë përfaqësues të autorizuar**

### **1.1.1 Rasti *Ovçara***

Gjykimi i përsëritur kundër 16 të akuzuarve për rastin *Ovçara* ka filluar më 13. 03. 2007. Deri në fund të vitit 2008 janë mbajtur 56 seanca gjyqësore, gjatë të cilave janë marrë në pyetje 18 të akuzuar, 60 dëshmitarë dhe pesë ekspertë gjyqësor. Kryetar i kolegjit gjykues është gjykatësi Vesko Krstajiq.<sup>1</sup> Gjykimi i të akuzuarve për vrasjen e rreth 200 robërve të luftës në fermën *Ovçara*, në Vukovar, ka filluar më 13.03.2007, pasi Gjykata Supreme e shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Në gjykimin e përsëritur, kolegji gjykues ka marrë vendim për bashkimin e procedurës e cila për të njëjtin rast dhe për të njëjtën vepër penale zhvillohet kundër Sasha Radakut dhe Milorad Pejiqit.

Gjatë procesit të përsëritur, Gjykata veproi në tërësi sipas vërejtjeve të bëra nga Gjykata Supreme, që gjithsej ishin pesëmbëdhjetë. Është me rëndësi të përmendet se arsyet e Gjykatës Supreme për shfuqizimin e vendimit të marrë në shkallën e parë janë politike dhe nuk kanë të bëjnë me arsye relevante juridike, ligjore dhe faktike, të cilat i trajton vendimi i shfuqizuar i Gjykatës së Shkallës së Parë në rastin *Ovçara*. Dëshmia më bindëse se vërejtjet e Gjykatës Supreme nuk kishin të bëjnë me përfundimet juridike dhe faktike të vendimeve të shkallës së parë është pikërisht ky gjykim i përsëritur.

Gjykata Supreme kërkoi të dëgjohet një nga avokatët mbrojtës për t'u verifikuar nëse ai ka qenë prezent gjatë marrjes në pyetje të klientit të tij nga policia, edhe pse ekziston procesverbali zyrtar i përgatitur nga organi përkatës shtetëror dhe i nënshkruar nga ana e avokatit. Në gjykimin e përsëritur avokati ka pohuar se ishte prezent gjatë marrjes në pyetje të klientit të tij, që vërtetohet edhe nga nënshkrimi i tij në procesverbal.

---

<sup>1</sup> Anëtarët e kolegjit gjykues ishin gjykatësja Gordana Bozhiloviq-Petroviq dhe gjykatësja Vinka Beraha-Nikiqeviq, kurse pas 01.10.2007, gjykatësja Bozhiloviq-Petroviq është zëvendësuar nga gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq.

Në kundërshtim me dispozitat e procedurës ligjore dhe plotësisht jashtë praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme ka kërkuar ekzaminimin psikiatrik të dëshmitarit bashkëpunëtor. Gjykata e Shkallës së Parë e kërkoi këtë ekspertizë e cila gjeti se gjendja psikike e dëshmitarit është në përputhje me moshën, se ai është në gjendje t'i kuptojë ngjarjet e më pas t'i riprodhojë ato dhe se ka inteligjencë mbi mesatare.

Kodi i procedurës penale ka dispozita shumë të qarta dhe precize sa i përket procedurës së ekspertizës. Kodi parasheh që në rast të gjetjeve kundërthënëse në mes të ekspertëve individual dhe komisionit të ekspertëve, të pranohet si i vlefshëm konstatimi i komisionit të ekspertëve. Pa marrë parasysh faktin se komisioni i ekspertëve kishte pohuar me siguri se një nga të akuzuarit, përkundër lëndimeve të konstatuara, kishte mundësi të ketë qenë në Ovçar në kohën e ngjarjes, Gjykata Supreme ka kërkuar që për këtë rrethanë të deklarohet Komisioni i Mjekësisë Ligjore të Fakultetit të Mjekësisë në Beograd. Komisioni i Mjekësisë Ligjore konstatoi gjithashtu se ekzistonte mundësia që i akuzuari të ketë qenë në Ovçar në kohën e ngjarjes.

E njëjta gjë vlen edhe sa u përket vërejtjeve tjera të Gjykatës Supreme në lidhje me veprimet e Gjykatës së Shkallës së Parë. Asnjë nga vërejtjet e Gjykatës Supreme nuk ishte e bazuar, përkundrazi, të gjitha verifikimet e bëra i kanë vërtetuar dhe fuqizuar edhe më shumë përfundimet në të cilat kanë ardhur gjykatat e shkallës së parë.

### **1.1.2. Rasti Suhareka**

Gjykimi i tetë pjesëtarëve të MPB-së së Serbisë për krime të luftës kundër popullsisë civile ka filluar më 2.10.2006, para kolegjit gjyqësor të cilin e udhëheq gjykatësja Vinka Beraha-Nikiqeviq<sup>2</sup>. Pjesëtarëve të MPB-së së Serbisë u vihet në barrë se më 26 mars të vitit 1999, në Qendrën Tregtare, e cila gjendet në qendër të Suharekës, kanë vranë 49 anëtarë të familjes Berisha dhe kanë organizuar varrosjen e trupave në një vend të fshehtë në Prizren. Deri në fund të vitit 2008 janë mbajtur 76 seanca gjatë të cilave janë dëgjuar 113 dëshmitarë, tre nga të cilët kanë dëshmuar me pseudonime, një me fytyrë të mbrojtur, një dëshmitar tjetër përmes video lidhjes, si dhe tre ekspertë gjyqësor.

Aktakuza përfshin vetëm ngjarjen e datës 26.03.1999, përkundër faktit se pjesëtarët e këtyre formacioneve policore më 25.03.1999, në po të njëjtën rrugë, kanë vranë të paktën 10 civilë shqiptarë, për të cilën ekziston procesverbali mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, i përgatitur nga gjykatësi hetues i Gjykatës së Qarkut në Prizren. Duke marrë parasysh vendin e vrasjeve, kryesit, viktimat dhe kontinuitetin kohor (vrasje ditë pas dite), do të duhej që në aktakuzë të përfshihen edhe krimet e kryera më 25.03.1999. Kështu siç është tani, aktakuza nuk është e plotë, ajo është selektive dhe mundëson që një krim i rëndë të kalojë i pandëshkuar.

Aktakuza bazohet në dëshmitë e të akuzuarit Nenad Jovanoviq, ndihmës komandant i stacionit policor në Suharekë, policit dëshmitar Velibor Veljkoviq, të punësuar në MPB-

---

<sup>2</sup> Anëtarët e kolegjit gjyqësor: gjykatësja Goradna Bozhiloviq-Petroviciq dhe gjykatësi Vesko Krstajiq, kurse nga 1.10.2007 në vend të gjykatësit Bozhiloviq, anëtare e kolegjit ishte gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq.

në e komunës së Suharekës, dy rezervistëve dëshmitarë (dëshmitarit A dhe Novica Gjorgjeviqit), disa dëshmitarëve romë të cilët menjëherë pas krimit i kanë ngarkuar në kamion trupat e të vrarëve në piceri dhe dëshmitarëve të dëmtuar - të mbijetuarve Shyrete Berisha, Vjollcë Berisha, Agron Berisha (i cili ngjarjen e ka parë nga dritarja) dhe Fejzullah Berisha. Dëshmitë e tyre janë mbështetur me prova të shumta materiale, si dhe me pjesë të dëshmimeve të një numri të madh të dëshmitarëve tjerë. Kolegji gjykues, në mënyrë krejtësisht të pazakontë për praktikën gjyqësore, ka kërkuar ekzaminim psikiatrik për të gjithë dëshmitarët që në gjykatë kanë thënë të vërtetën për atë që kanë parë. Megjithatë, gjykata nuk ka kërkuar ekspertizë të ngjashme edhe për dëshmitarët të cilët kanë mundur dhe është dashur të thonë shumë më tepër për këtë ngjarje, por nuk e kanë bërë atë.

Një prej karakteristikave të këtij gjykimi është se të gjithë dëshmitarët që gjatë kohës kritike punonin në administratën komunale, gjyqësi, polici dhe ushtri, në shqyrtimin kryesor pohuan se nuk ishin në dijeni të vrasjes së 49 anëtarëve të familjes Berisha dhe se për këtë kishin mësuar pas ardhjes në Serbi. Të gjithë pohonin se për vrasjen kanë marrë vesh kur ka filluar gjykimi kundër Slobodan Milosheviqit. Vrasja ka ndodhur në mes të ditës, në qendër të Suharekës, pesë metra larg godinës së komunës dhe 100 metra larg prej stacionit policor. Suhareka është një vend i vogël dhe është e pabesueshme që asnjë nga institucionet kompetente nuk ka kurrfarë njohurish për ngjarjen. Përpos që me dëshmitë e tyre të rrejshme i mbrojnë të akuzuarit, indiferenca e këtyre dëshmitarë për rastin në fjalë tregon se vrasja e shqiptarëve për ata nuk paraqet krim.

Gjatë procedurës nuk është sqaruar se cili nivel i lartë komandues kishte komandën ndaj pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Policisë (NJSP), e cili ndaj policëve të MPB-së për komunën e Suharekës. Nuk është diskutuar posaçërisht roli i Shtabit të MPB-së për Kosovë, në krye të cilit ishte gjenerali Sreten Lukiq. Gjithë dëshmitarët që kishin njohuri relevante pohonin se komandanti i NJSP-ve ishte gjenerali Obrad Stevanoviq, përderisa vet Stevanoviqi pohoi para gjykatës se gjatë kohës së ngjarjeve ai nuk ishte komandant i NJSP-së, por këshilltar i Ministrit të Punëve të Brendshme për Kosovë. Gjithashtu, nuk është sqaruar raporti mes forcave policore dhe njësisë ushtarake, në kuptimin e subordinimit, për faktin se gjatë kohës së luftës ato kanë marrë pjesë në aksione të përbashkëta.

Mbrojtësit e të akuzuarve gjatë parashtrimit të pyetjeve, paraqitjes së propozimeve procedurale dhe kundërshtimeve në pyetjet e gjykatës, prokurorit dhe përfaqësuesve të të dëmtuarve, shpesh kanë paraqitur qëndrime politike, me çka e kanë vështirësuar procedurën gjyqësore dhe kanë vënë në pikëpyetje paanshmërinë dhe objektivitetin e vetë procesit gjyqësor.

### **1.1.3. Rasti Bytyqi**

Gjykimi po zhvillohet kundër dy pjesëtarëve të Grupit Operativ-Vëzhgues (GOV) të NJSP-së së MPB-së së Serbisë, për pjesëmarrje në kryerjen e veprës penale të krimit të luftës kundër robërve të luftës. Kryetar i kolegjit gjykues është gjykatësi Vesko Krstajiq.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Anëtarë të kolegjit gjykues: gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq dhe gjykatësja Vinka Beraha-Nikiçeviq.

Që nga fillimi i gjykimit, më 13.11.2006, deri në fund të shtatorit të vitit 2008, janë mbajtur 31 seanca gjyqësore dhe janë dëgjuar 96 dëshmitarë, një prej të cilëve është dëshmitar – palë e dëmtuar.

Aktakuza është selektive dhe përfshin vetëm pjesëmarrësit në veprë penale, por jo edhe kryesit dhe urdhërdhënësit. Që nga fillimi i procedurës penale për zbardhjen e vrasjeve dhe zbulimin e kryesve, hetimi ishte i kufizuar në aktorët më pak të rëndësishëm të përfshirë në krim, me qëllim që të mbrohen njësitet e caktuara të policisë, funksionarët e lartë të NJSP-së dhe MPB-së së Serbisë. Në hetime nuk janë përfshirë ndihmës Ministri i Punëve të Brendshme, Vlastimir Gjorgjeviq, dhe pjesëtarët e Njësisë për Operacione Speciale (NJOS) të Resorit të Sigurimit Shtetror të Serbisë, edhe pse pjesëmarrja e tyre në këtë vrasje është plotësisht e sigurt. Nga vetë deklaratat e të akuzuarve del se iniciativa për arrestimin e vëllezërve Bytyqi ishte marrë nga ndihmës Ministri, gjenerali Vlastimir Gjorgjeviq, pasi këta kishin vuajtur dënimin me burgim për kundërvajtje. Përpos kësaj, në kampin policor të fshatit Petrov, ku janë mbajtur vëllezërit Bytyqi pas vuajtjes së dënimit me burgim në Gjykatën e Qarkut në Prokuplë, instruktorët kryesor ishin pjesëtarët e NJOS, pa njohurinë e të cilëve nuk ka mund të bëhet asgjë në atë kamp. Organet e punëve të brendshme dhe Prokuroria për krimet të luftës kanë lejuar që oficeri i lartë i MPB-së, Goran Radosavljeviq – Guri, ta lëshojë vendin dhe të jetë i paarritshëm për drejtësinë, në kohën kur Prokuroria kishte filluar procedurën kundër tre oficerëve të lartë të MPB-së së Serbisë, të cilët edhe ishin arrestuar, prandaj së bashku me dy të akuzuarit, në paraburgim po mbaheshin gjithsej pesë oficerë të MPB-së. Në rrethanat kur në paraburgim ndodheshin pesë pjesëtarë të MPB-së së Serbisë, në pozita shumë më të ulëta se ajo e Goran Radosavljeviq, dhe kundër tyre po zhvilloheshin hetime për veprë të rëndë penale, ata me siguri se do të ishin të gatshëm të ballafaqohen me Radoslavleviqin për një varg detajesh sa i përket veprës penale. Kështu si rrodhën ngjarjet, paraqitja e tij në gjykatë, kur më askush nuk gjendej në paraburgim, e humb rëndësinë sepse ballafaqimi i tyre në rrethana tjera nuk ka kuptim dhe nuk i kontribuon ndriçimit të vrasjes. Fakti se Goran Radosavljeviq Guri është kthyer lirisht në Serbi dhe se gjatë procedurës hetimore dhe shqyrtimit kryesor është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, sjell në përfundim se ai ishte në kontakt me organet shtetërore dhe kishte garanci të forta se nuk do të akuzohej. Është e pakuptueshme pse kolegji gjyqësor nuk e ka marrë në pyetje Milorad Lukoviqin – Legia që në fillim të procesit gjyqësor kundër vëllezërve Bytyqi, sepse ai në kohën e vrasjes së tyre ishte komandant i NJOS, oficerët e së cilës ishin instruktorë në kampin e fshatit Petrov. Ai është marrë në pyetje vetëm pasi i janë shqiptuar katër dënime me nga 40 vite burgim, pra atëherë kur më nuk kishte asnjë interes për të zbuluar çfarëdo detaji të ri që ka të bëjë me veprimtarinë e NJOS, gjë që edhe u dëshmuar në shqyrtimin kryesor, me datë 22.12.2008, kur refuzoi të dëshmojë. Gjatë gjykimit nuk është sqaruar në masë të duhur roli i komandantit të Seksionit për të huajt në SUP-in e Prokuplës, Zoran Stankoviq, dhe udhëheqësit të burgut të qarkut në Prokuplë, Aleksandar Gjorgjeviq, rreth vrasjes së vëllezërve Bytyqi.

Shikuar në tërësi, gjykimi është shumë i pazakontë. Janë akuzuar disa persona që kanë pasur rol dytësor në kryerjen e krimit, kurse jashtë aktakuzës kanë mbetur kryerësit e drejtpërdrejt, bashkëkryerësit, ndihmësit e vërtetë dhe nxitësit. E gjithë kjo tregon se procesi është nisur dhe organizuar me qëllim që, për aq sa është e mundur, të kënaqen

kërkesat e administratës amerikane që Serbia ta zbardh rastin e tyre, sepse vëllezërit Bytyqi ishin shtetas të SHBA-ve. Rezultati përfundimtar i këtij gjykimi është mbrojtja e oficerëve të lartë të MPB-së së Serbisë nga përgjegjësia penale dhe simulimi i drejtësisë.

#### **1.1. 4. Rasti i Zvornikut I dhe II**

Rasti i Zvornikut është rasti i parë të cilin Tribunali i Hagës ia ka dorëzuar Kolegjit për krime të luftës së Gjykatës së Qarkut në Beograd [derisa ishte në fazën e hetimeve]. Gjykimi për krime të luftës kundër popullsisë civile ndaj ish kryetarit të komunës së Zvornikut, Branko Grujiq, ish komandantit të Mbrojtjes Territoriale (MT), Branko Popoviq, dhe vullnetarëve Dragan Slavkoviq, Ivan Koraq, Sinisha Filipoviq dhe Dragutin Dragiqeviq, filloi më 28.11.2005, para kolegjit gjykues të cilin e udhëhiqte gjykatësja Tanja Vukoviq<sup>4</sup>. Branko Grujiq dhe Branko Popoviq u akuzuan për deportimin e 1.800 myslimanëve nga Kozluka, me 26.06.1992, për burgosjen, torturimin dhe vrasjen e myslimanëve në llogoret *Çelopek*, *Ekonomia* dhe *Ciglana*, gjatë periudhës prej fillimit të prillit deri në fund të korrikut të vitit 1992, kurse të tjerët u akuzuan për torturimin dhe vrasjen e civilëve myslimanë në llogoret e lartë përmendura.

Prej fillimit të gjykimit deri në shpalljen e vendimit ndaj Dragan Slavkoviqit, Ivan Koraqit, Sinisha Filipoviqit dhe Dragutin Dragiqeviqit, më 12.06.2008, janë mbajtur gjithashtu 101 seanca gjyqësore, janë dëgjuar 89 dëshmitarë dhe janë lexuar dëshmitë nga hetimi i katër dëshmitarëve – të dëmtuarve, si dhe një numër i dokumenteve të shkruara.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 26.05.2008, prokurori ka paraqitur aktakuzën e ndryshuar dhe ka propozuar që procedura ndaj të akuzuarve Branko Grujiq dhe Branko Popoviq të ndahet nga procedura kundër të akuzuarve tjerë. Në të njëjtën seancë, kolegji gjykues mori vendimin për ndarjen e procedurës kundër Branko Grujiqit dhe Branko Popoviqit. Vendimi kundër Dragan Slavkoviqit, Ivan Koraqit, Sinisha Filipoviqit dhe Dragutin Dragiqeviqit është marrë dhe është shpallur më 12.06.2008. I akuzuari Slavkoviq është dënuar me 15 vite burgim, Koraqi me 13 vite, Filipoviqi me tri vite, kurse i akuzuari Dragiqeviq është liruar nga akuzat.

Vendimi i shqiptuar është i pari i këtij lloji - krime të luftës të kryera në komunën e Zvornikut. Të dënuarit janë vullnetarë nga Serbia që shkuan në mënyrë të organizuar në Zvornik, me dijeninë dhe përkrahjen e MPB-së së Serbisë. Të gjithë janë dënuar si kryes të drejtpërdrejt të veprimeve që përbëjnë vepër penale të krimeve të luftës.

Me aktakuzë nuk janë përfshirë të gjithë personat përgjegjës për krimet e kryera në Zvornik. Për shembull, llogori në *Çelopek*, ku janë torturuar dhe vrarë myslimanët e marrë peng, është ruajtur nga pjesëtarët e uniformuar dhe të armatosur të policisë, kurse për këtë nuk janë akuzuar as ata e as eprorët e tyre. Nuk ishte e mundur të gjykohen as kryesit e krimeve më të rënda në llogor: Dushan Vučkoviq i njohur me nofkën Repiq (vdiq 10 ditë para fillimit të gjykimit), njëfarë *Pufti* (i paarritshëm për policinë), personi me nofkën *Pivarska* (u vra gjatë luftës),.

---

<sup>4</sup> Anëtarë të kolegjit ishin gjykatësit Olivera Angjelkoviq dhe Vesko Krstajiq.

Edhe pse të dënuarit nuk kishin ndonjë pushtet dhe autorizim të posaçëm, ata ishin kryerësit e drejtpërdrejt të krimeve dhe përgjegjësia e tyre ishte e madhe. Ata kanë kryer krime aq të rënda sa dënimi i vetëm adekuat do të duhej të ishte dënimi më i rëndë i paraparë me ligj - 20 vite heqje lirie. Gjykata u dha rëndësi tepër të madhe rrethanave lehtësuese për të dënuarit, duke përmendur moshën e re, rrethanat familjare, sëmundjen, pendimin, që kanë rëndësi në rastet e veprave klasike penale, përderisa në rastet e krimeve të luftës ato janë të deplasuar.

Kolegji gjykues bëri përpjekje të madhe që ta vërtetojë gjendjen faktike, por kjo ishte e vështirë sepse dëshmitarët më të rëndësishëm ishin të mbijetuarit e llogoreve të mbajtur në kushte çnjerëzore, me frikë të madhe për jetën e tyre, të urdhëruar të shohin kah muri apo në dysheme, disa prej tyre kohë pas kohe edhe në gjendje të pavetëdijshme. Prandaj, në rrethana të tilla është plotësisht e kuptueshme që dëshmitë e tyre nuk janë identike në të gjitha detajet. Gjykata e ka përcaktuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, si dhe ka ofruar arsye bindëse pse i pranon disa prova kurse disa të tjera jo. Mirëpo, nuk u arrit që të përmirësohen të metat e aktakuzës sa u përket provave mbi përzierjen e të akuzuarve Dragiqeviq dhe Filipoviq, si dhe fakti se në aktakuzë nuk janë përfshirë funksionarët komunal dhe pjesëtarët e policisë dhe ushtrisë, roli i të cilëve pa dyshim se është treguar gjatë gjykimit. Për shembull, nuk është akuzuar Stevo Radiq, funksionari komunal i cili ka marrë vendime për një numër të madh të çështjeve që kishin të bëjnë me llogoret dhe personat e mbajtur aty, pastaj komandanti i stacionit policor, Marinko Vasiliq, komandanti i rojeve dhe rojet në *Çelopek*, Cvijetko Joviq, Sredo Vukoviq dhe të tjerët, drejtori i ndërmarrjes *Drina-trans*, Dragan Spasojeviq, i cili ka marrë pjesë në organizimin e transportit të personave të burgosur në llogore dhe të tjerët.

Më 22.10.2008, Prokuroria për krime të luftës e zgjeroi aktakuzën kundër Branko Grujiqit dhe Branko Popoviqit për krime të luftës kundër popullsisë civile, duke ua vënë atyre në barrë edhe vrasjen e rreth 700 meshkujve myslimanë - civilë, të cilët më parë janë ndarë nga familja dhe janë mbajtur në Qendrën Shkollore Teknike (QSHT) në Karakaj, prej ku janë nxjerrë dhe janë pushkatuar. Trupat e rreth 250 meshkujve u gjetën në varrezën masive në malin Crni Vrh, përderisa trupat e të varrëve tjerë nuk janë gjetur ende. Aktakuza e ngarkon Grujiqin dhe Pavloviqin për kryerjen e veprës penale me paramendim eventual, që do të thotë se ata kishin njohuri për krimin e kryer dhe e kishin pranuar atë. Këtu nuk bëhet fjalë për përgjegjësi komanduese, por për përgjegjësi direkte dhe të drejtpërdrejt [formë e rëndë e përgjegjësive penale]. Në seancën kryesore që u mbajt më 20.11.2008, kolegji gjykues mori vendim për bashkimin e procedurës penale e cila tashmë po zhvillohej sipas aktakuzës së zgjeruar ndaj Grujiqit dhe Popoviqit [deportimi i myslimanëve nga Kozluka, torturimet dhe vrasjet në llogoret *Çelopeku*, *Ekonomia dhe Ciglana*]. Të akuzuarit nuk ishin të gatshëm të deklarohen për aktakuzën e zgjeruar, me arsyetimin se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur. Në shqyrtimin kryesor të 29 dhjetorit të vitit 2008, të akuzuarit kanë paraqitur mbrojtjen e tyre. Nuk kanë arritur të prezantojnë asnjë argument të vlefshëm me të cilin do t'i hidhnin poshtë faktet për pjesëmarrjen e tyre shumë aktive në krimet ndaj civilëve myslimanë – që është krimi më të madh pas Srebrenicës.



### **1.1.5. Rasti Podujeva II**

Gjykimi kundër katër pjesëtarëve të njësisë “*Skorpionët*”, përbërje rezervë e MPB-së së Serbisë, ka filluar me 8 shtator të vitit 2008, para kolegjit gjykues me të cilin udhëheqë gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq<sup>5</sup>. Aktakuza i ngarkon të akuzuarit se më 28 mars të vitit 1999, kanë vrarë 14 gra dhe fëmijë shqiptarë në Podujevë të Kosovës, kurse pesë fëmijë i kanë plagosur rëndë. Deri në fund të vitit janë mbajtur 12 seanca gjyqësore, janë dëgjuar të akuzuarit dhe nëntë dëshmitarë, një nga të cilët është prezantuar me pseudonim, si dhe shtatë të dëmtuar.

Kjo lëndë është specifike për faktin se në lidhje me të njëjtën ngjarje është marrë një vendim i plotfuqishëm, me të cilën pjesëtari i njësisë së *Skorpionëve*, Sasha Cvjetan, është dënuar me 20 vite burgim. Gjithashtu, me vendim të plotfuqishëm ka përfunduar procedura sipas së cilës është liruar nga përgjegjësia pjesëtari tjetër i “*Skorpionëve*”, i cili në procesin e përsëritur gjyqësor paraqitet në cilësinë e dëshmitarit me pseudonimin *P I*. Gjykimi në këtë rast është lehtësuar nga fakti se një numër i madh i dëshmive për të njëjtën ngjarje dhe të njëjtën vepër penale janë prezantuar në procedurën kundër Sasha Cvjetanit. Në gjykimin e parë kundër Sasha Cvjetanit nuk ka dëshmuar dëshmitari *PI*, kurse në këtë procedurë ai e ka rolin e dëshmitarit okular të ngjarjes. Dëshmia e pjesëtarit tjetër të “*Skorpionëve*” Goran Stopariq kundër Sasha Cvjetanit, është vërtetuar përsëri gjatë mbrojtjes së të akuzuarit Zheljko Gjukiqit, i cili ka deklaruar se ditën e nesërme pas kryerjes së krimit, Stopariqi e ka përshkruar ngjarjen që ka ndodhur në oborrin e shtëpisë në të njëjtën mënyrë siç e kishte bërë në gjykimin kundër Sasha Cvjetanit.

Gjatë procesit të deritanishëm është dëshmuar pa dyshim se pjesëtarët e MPB-së së Serbisë, SAJ-it dhe njësia “*Skorpionët*” në Podujevë kishin për detyrë që t’i largojnë shqiptarët nga shtëpitë e tyre [nga Kosova].

Gjykimin i ka dhënë peshë të veçantë pjesëmarrja e katër fëmijëve të mbijetuar, të cilët me dëshminë e tyre dhe identifikimin e kryerësve i kanë ndihmuar shumë vërtetimit të gjendjes faktike.

Ky rast shënon herën e parë kur Prokuroria fillon një procedurë të re penale ndaj personave tjerë të përfshirë në këtë krim, duke shfrytëzuar dëshmitë dhe të dhënat nga lënda kundër Sasha Cvjetanit. Prokuroria nuk e ka zbatuar këtë praktikë në lëndët Ovçara dhe Suhareka, që paraqet lëshim serioz gjatë procedimit të krimeve të luftës dhe lë të dyshohet se Prokuroria i ka ngritur aktakuzat në mënyrë selektive.

### **1.1.6. Rasti Lovas**

Gjykimi ndaj 14 të akuzuarve për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, mes të cilëve katër oficerëve të ish APJ-së, gjashtë pjesëtarëve të formacionit paraushtarak “*Dushan Silni*” dhe katër banorëve të Lovasit, pjesëtarë të qeverisë lokale të vitit 1991, filloi më 17 prill të vitit 2008. Me kolegjin gjykues udhëheq gjykatësja Olivera

---

<sup>5</sup> Anëtarët e kolegjit gjykues: gjykatësi Vesko Krstajiq dhe gjykatësja Vinka Beraha-Nikiqeviq.

Angjelkoviq.<sup>6</sup> Deri në fund të tetorit janë zhvilluar 31 seanca gjyqësore, gjatë të cilave gjykata dëgjoi 14 të akuzuar dhe nëntë dëshmitarë.

Aktakuza ngarkon disa të akuzuar si kryes të drejtpërdrejt, kurse disa të tjerë si bashkëpjesëmarrës [përgjegjësia e atyre që zbatojnë urdhrat] . Bëhet fjalë për tri kategori të kryerësve të krimeve, së pari, oficerët e APJ-së, së dyti, vullnetarët dhe së treti, përfaqësuesit e pushtetit lokal. Aktakuza e ka definuar qartë përgjegjësinë e individëve nga secili prej grupeve të përmendura, që nuk ishte punë e thjeshtë duke pasur parasysh se detyrat e tyre gërshetohen dhe se të akuzuarit gjatë hetimeve e kanë hedhur përgjegjësinë tek njëri-tjetri.

Gjykimin e karakterizojnë disa veçanti. Para së gjithash, të akuzuarit nuk janë marrë në pyetje sipas radhitjes në aktakuzë. Së pari është marrë në pyetje i akuzuari i katërmbëdhjetë, Aleksandar Nikolaidis, i cili ishte i gatshëm të paraqesë një varg argumentesh që ngarkojnë të akuzuarit nga të tre grupet e përmendura. Ai ofroi arsye shumë bindëse për përgjegjësinë e të akuzuarit të parë, Ljubana Devetaka, i cili në mbrojtjen e tij ishte i detyruar të deklarohet për pohimet e të akuzuarit Nikolaidis. Në pozitë të njëjtë ishin edhe të akuzuarit tjerë. Përpos kësaj, pas prezantimit të mbrojtjes nga ana e të akuzuarve, kryetarja e kolegjit gjykues ia tregonte secilit prej tyre deklaratat e të akuzuarve të tjerë dhe dëshmitarëve të dhëna gjatë hetimit apo shqyrtimit kryesor, si dhe dëshmitë e shkruara, gjë që është e pazakontë në praktikën gjyqësore. Përmes kësaj, që në start ka filluar sqarimi i të gjitha aspekteve të aktakuzës dhe përgjegjësia e secilit të akuzuar. Për dallim nga disa gjykime tjera, kryetarja e kolegjit gjykues të këtij procesi i njuh të gjitha detajet e procesverbalit që numëron disa mijëra faqe, që ndihmon zhvillimin më të shpejtë dhe më kualitativ të procesit gjyqësor. Problemi i cili u shfaq në fillim të procedurës së paraqitjes së provave, ishte mungesa e gatishmërisë së dëshmitarëve të dëmtuar nga Kroacia që të marrin pjesë në shqyrtimin kryesor – për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore, moshës së shtyrë, apo qëndrimit të pa luhatur se nuk duan të shkojnë në Serbi. Në organizim të FDH-së, gjykimin e monitorojnë rregullisht viktimat dhe anëtarët e familjeve të viktimave, që i ndihmon motos se drejtësia jo vetëm që duhet të vihet në vend, por edhe duhet të shihet.

### **1.1.7. Rasti Emini**

Gjykimi i të akuzuarve Milosh Simonoviç dhe Dragisha Markoviç, pjesëtarë të MPB-së së Serbisë, ka filluar para Gjykatës së Qarkut në Nish më 14.09.2004, dhe është zhvilluar në gjykatoren e zbrazët, edhe pse publiku nuk ishte i përjashtuar nga seanca. Të akuzuarve u vihet në barrë se më datë 05.05.1999 e kanë privuar nga jeta shqiptarin Isa Emini nga Prishtina, pasi kishin hyrë më parë në banesën e tij dhe e kishin larguar të shoqen në dhomën fqinje, të ndjerin e kanë qëlluar me dy plumba në kokë. Shqyrtimi kryesor është shtyrë disa herë gjatë procedurës së zhvilluar në Gjykatën e Shkallë së Parë, për shkak të mosardhjes së të akuzuarve të cilët po mbrohen në liri. Gjithashtu, shqyrtimi kryesor është dashur të nis nga fillimi dy herë, për shkak të skadimit të afatit. Edhe pse gjykata e ka për detyrë t'i vërtetojë provat materiale dhe të sjellë vendim të ligjshëm, ajo gjatë gjithë procedurës barrën e provave e hodhi në palën e dëmtuar. Procedura pranë

<sup>6</sup> Anëtarë të kolegjit gjykues ishin gjykatësja Tanja Vukoviç dhe gjykatësi Dragan Plaziniç.

Gjykatës së Shkallës së Parë përfundoi më 15.06.2007 me shpalljen e vendimit për lirimin e të akuzuarve, tetë vite pas kryerjes së vrasjes. Kolegji gjykues, me të cilin udhëhiqte gjykatësi Zoran Krstiq<sup>7</sup>, gjeti se nuk është dëshmuar faji i të akuzuarve.

Prokurori e kualifikoi veprën si vrasje, në vend se ta kualifikojë atë si krim kundër popullsisë civile, duke pasur parasysh se vrasja kishte ndodhur gjatë kohës së konflikteve të armatosura në Kosovë.

Gjykata Supreme e shfuqizoi vendimin e shkallës së parë më 30.06.2008 dhe e ktheu lëndën për rigjykim. Dy herë gjatë vitit 2008 u caktua shqyrtimi kryesor, por ai nuk u mbajt sepse të akuzuarit nuk u paraqitën në gjykatë. Përkundër kësaj, gjykata nuk po kërkon që të akuzuarit të sillen me forcë apo të paraburgosen. Të dëmtuarit përfaqësohen nga juristja e FDH-së.

### ***1.1.8.Rasti Pakshec***

Kolegji i të pestëve pranë Gjykatës së Qarkut në Novi Sad, nën udhëheqjen e gjykatësit Zoran Drecun, më 19.10.2007 mori vendimi me të cilin Slavno Petroviq, Nikola Dukiq dhe Petar Qiriq shpallen fajtorë dhe atë: Slavko Petroviq dhe Nikola Dukiq për veprë penale të vrasjes, që sanksionohet sipas nenit 114 paragrafi 1, pika 5 dhe 9 e Ligjit Penal, kurse Slavko Petroviq, Petar Qiriq dhe Nikola Dukiq për veprën penale të dhunimit, nga neni 103 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Republikës së Serbisë, prandaj Slavko Petroviqit i është shqiptuar një dënim i vetëm në kohëzgjatje prej 40 vite heqje lirie, Nikola Dukiq një dënim i vetëm në kohëzgjatje prej 30 vite heqje lirie, kurse Petro Qiriq dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 vite heqje lirie, për shkak të kryerjes së veprës penale të dhunimit, përderisa ai është liruar nga përgjegjësia për veprën penale të vrasjes. Slavko Petroviqi dhe Nikola Dukiqi janë dënuar sepse më 9.04.1992, në Vukovar, Kroaci, e kanë plaçkitur dhe vrarë nga lakmia për përfitim familjen kroate katër -anëtarëshe Pakshec, kurse më pas i kanë hedhur trupat e të vrarëve në bunar. Po të njëjtën ditë, këta tre të akuzuar e kanë dhunuar në Vokovar, Branislava Pleshën, serbe, fqinje e familjes Pakshec. Gjykata Supreme, me vendimin e vet të datës 2.12.2008, ua ka vërtetuar dënimin me burgim Petroviqit dhe Dukiqit, ndërsa Qiriqit ia zvogëloi dënimin nga 12 në 10 vite heqje lirie.

Gjykimi ishte efikas, të dënuarve u janë shqiptuar dënime të ashpra, adekuate për krimin e rëndë që kanë kryer. Të gjitha instancat gjyqësore që janë marrë më këtë lëndë: Prokuroria, Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata Supreme e Serbisë ishin në nivel të lartë profesional dhe rastin e kanë përmbyllur në mënyrë objektive, dhe ajo çka është me rëndësi të veçantë, duke marrë maksimalisht parasysh faktin se është fjala për veprë penale jashtëzakonisht të rëndë. Në mungesë të ligjeve të uniformuara në Serbi dhe dispozitave tjera ligjore, për krime të luftës nuk mund të shqiptohet dënim më i rëndë se 20 vite burgim, pa marrë parasysh numrin e të vrarëve, përderisa për vrasjen e disa personave mund të shqiptohet dënimi prej 40 viteve burgim. Kualifikimi juridik i veprës

---

<sup>7</sup> Anëtarë të kolegjit ishin gjykatësi Milan Nikoliq dhe gjykatësit-porotë Aleksandar Milenoviq, Gordana Krsmanoviq dhe Zagorka Cvijiq.

penale si vrasje e disa personave mundësoi që në rastin konkret të akuzuarit për këtë krim monstruoz të marrin një dënim më adekuat, më të drejtë dhe më të merituar.

Gjykimi për veprën penale të dhunimit ishte i mbyllur për publikun, që është në përputhje me ligjin. Të dëmtuarit janë përfaqësuar nga avokatja e FDH-së.

### **1.1.9. Roli i përfaqësuesit të autorizuar të viktimave**

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Serbisë në nenin 66 paragrafi 1, parasheh që i dëmtuari të ketë mundësi t'i realizojë të drejtat e tij gjatë procedurës penale përmes përfaqësuesit të autorizuar. Edhe pse përfaqësuesi i autorizuar nuk është palë në procedurë [por vetëm pjesëmarrës], të drejtat e tij në shqyrtimin kryesor janë të mëdha: ai mund t'i marrë në pyetje të akuzuarit, dëshmitarët, ekspertët dhe të dëmtuarit, mund të paraqesë vërejtje për pyetjet e pjesëmarrësve tjerë në procedurë, mund t'i komentojë dëshmitë e pjesëmarrësve të dëgjuar në procedurë, mund të propozojë dëshmi tjera dhe ka të drejtë ta paraqesë fjalën përfundimtare. Gjatë procesit hetimor dhe ankimor, të drejtat e përfaqësuesit të autorizuar janë minimale [gjatë procedurës hetimore përfaqësuesi i autorizuar mund të marrë pjesë gjatë marrjen në pyetje të personave të dëmtuar, inspektimit të vendit të ngjarjes, ekspertizës]. Përfaqësuesi i autorizuar nuk ka të drejtë të paraqesë ankesa, me përjashtim në vendimin e gjykatës që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës. Për dallim nga sistemi juridik i Serbisë, në Bosnjë e Hercegovinë të drejtat e të dëmtuarve në të gjitha fazat e procedurës janë shumë të vogla. Gjatë shqyrtimit kryesor, të dëmtuarit mund të deklarohen mbi kërkesën pronësore-juridike. Në të gjitha fazat tjera të procedurës, i dëmtuari nuk ka kurrfarë të drejtash. Madje, i dëmtuari në B. e H. nuk mund të iniciojë ndjekje penale në rastet kur prokurori tërhiqet nga aktakuza, por vetëm mund t'ia paraqesë kundërshtimin e tij prokurorit më të lartë. Sipas ligjeve në Kroaci, të drejtat e të dëmtuarve janë identike me ato në Serbi, me të vetmin dallim se përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve duhet të jetë avokat, për dallim nga Serbia ku ai mund të jetë çdo person që zgjidhet nga pala e dëmtuar.

Vetëm në Serbi të dëmtuarit kanë përfaqësues të autorizuar para gjykatës. Në të gjitha rastet e prezantuara, të dëmtuarit përfaqësohen nga drejtoresha ekzekutive e Fondit për të Drejtën Humanitare, Natasha Kandiç, si dhe avokati i njohur për të drejtat e njeriut, Dragoljub Todorović, ku angazhimi i mbrojtësve për të drejtat e njeriut paraqet rris [individë dhe organizata për të drejtat e njeriut]. Pjesëmarrja e tyre në gjykimet për të drejtat e njeriut ndihmon në vërtetimin e provave materiale, gjendjes faktike dhe kontekstit në të cilin ka ndodhur krimi që është objekt i aktakuzës. Shumë pyetje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e vullnetarëve të Partisë Radikale të Serbisë në përgatitjen e luftës në B. e H. dhe në kryerjen e krimeve të luftës, janë shqyrtuar dhe diskutuar në mënyrë më të plotë, pikërisht për shkak të faktit se përfaqësuesit e autorizuar kanë njohuri mbi ngjarjen dhe kontekstin në të cilin janë kryer krimet.

FDH-ja bashkëpunon me Prokurorinë për krime të luftës në bazë të dokumentacionit me të cilin ajo disponon dhe të dhënave të grumbulluara në Bazën e shënimeve për krimet e luftës, të cilën ajo e ka formuar në dhjetor të vitit 2005. Kështu për shembull, FDH-ja i ka dorëzuar Prokurorisë për krime të luftës 45 dëshmi të viktimave dhe dëshmitarëve të

krimeve të luftës të kryera në Suharekë/Suva Reka dhe 37 dëshmi të viktimave dhe dëshmitarëve të krimeve të luftës në Tërnejë, në Kosovë, të kryera më 25 mars të vitit 1999. Dokumentacioni për krime të luftës në Suharekë/Suva Reka është pjesë përbërëse e procesverbalit gjyqësor. Në procesverbalin gjyqësor të rastit të *Zvornikut II* gjendet prova kyçe, të cilën FDH-ja ia ka dorëzuar kolegjit gjykues, se i akuzuari Marko Pavloviq ishte komandant i Shtabit të MT të Zvornikut gjatë kohës kur janë burgosur 700 myslimanë, të cilët pastaj u likuiduan brenda disa ditëve.

Duke iu falënderuar reputacionit që gëzon në mesin e viktimave, FDH-ja ka siguruar pjesëmarrjen e të gjithë [gjashtë] të dëmtuarve në lëndën *Podujeva II* dhe shumicën e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve nga Kosova në rastin Suhareka/Suva Reka. Prokuroria për Krime të Luftës ka nisur hetimin në lidhje me vrasjen e rreth 700 myslimanëve në komunën e Zvornikut [*Zvornik II*] në bazë të këmbënguljes së FDH-së dhe Shoqatës së Familjeve të Personave të Vrarëve dhe të Zhdukur të komunës së Zvornikut.

Gjykimet për krime të luftës në Serbi përcillen rregullisht nga anëtarët e familjeve të dëmtuara. FDH-ja organizon ardhjen e tyre për përcjelljen e gjyimit në rastet *Suhareka*, *Zvorniku II* dhe *Lovas*. FDH-ja organizon edhe ardhjen e kohëpaskohshme të Fatos Bytyqit nga SHBA-të, për të përcjellë gjykimin e dy pjesëtarëve të MPB-së së Serbisë për vrasje e tre vëllezërve të tij. Anëtarët e familjeve të viktimave nga Kosova vijnë në përcjellje të MPB-së së Serbisë, të cilët u ofrojnë atyre siguri fizike gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në Beograd. Ata udhëtojnë në Serbi përmes një procedure të posaçme. Duke pasur parasysh se autoritetet serbe nuk i njohin dokumentet personale të lëshuara nga UNMIK-u, FDH-ja para secilës seancë [një herë apo dy herë në muaj] i drejtohet MPB-së së Serbisë me lutje që t'u mundësojë hyrjen në Serbi anëtarëve të familjeve të viktimave, të evidentuar në listën e udhëtarëve. Gjatë vitit 2008 ka ndodhur që familjet e viktimave të presin në vendkalimin kufitar në Merdare, dy apo më shumë orë, derisa nuk e kanë marrë lejen për të kaluar në Serbi.

Në vitin 2008, FDH-ja ka paraqitur dy fletëparaqitje penale për krime të luftës kundër popullsisë civile me qëllim që ta stimulojë Prokurorinë për krime të luftës. Në muajin maj ka bërë paraqitje penale kundër oficerëve të lartë të Ushtrisë së Serbisë, mes të cilëve edhe kundër gjeneralit Bozhidar Deliq, për vrasjen e së paku 35 civilëve shqiptarë në fshatin Ternje/Trnje, në Kosovë, më 25 mars të vitit 1999. Në gusht të vitit 2008, FDH-ja ka bërë paraqitje penale kundër disa pjesëtarëve të Partisë Radikale të Serbisë për vrasjen [krim lufte] të së paku 35 romëve, në qershor të vitit 1992, në komunën e Zvornikut. Deri në fund të vitit 2008, Prokuroria nuk kishte paraqitur kërkesë për fillimin e hetimeve.

## **1.2. Monitorimi i Gjykimeve për Krime të Luftës në Serbi**

### **1.2.1. Rasti Slunj**

Kolegji për krime të luftës pranë Gjykatës së Qarkut në Beograd, shpalli më 08.07.2008 aktgjykimin me të cilin i akuzuari Zdravko Pashiq dënohet me burgim në kohëzgjatje prej tetë viteve, për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, nga neni 142 paragrafit 1 i LP të RFJ-së. Këtë lëndë Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë ia

kishte lënë Prokurorisë për krime të luftës së Republikës së Serbisë. Në të vërtetë, Gjykata e Zhupanisë në Karlovc për këtë veprë penale e kishte dënuar në mungesë Zdravko Pashiqin dhe të bashkakuzuarin Milan Grubjeshiqin me heqje lirie në kohëzgjatje prej 12 viteve. I gjykuari Grubjeshiq është duke vuajtur dënimin në Kroaci.

Aktakuza e ngarkon të akuzuarin Pashiq se si pjesëtar i policisë të së vetëshpallurës Republika Serbe e Krainës, sipas marrëveshjes paraprake me Milan Grubjeshiqin, në natën ndërmjet 22 dhe 23 dhjetorit të vitit 1991, e ka privuar nga jeta mjekun Dragutin Krushiq, i nacionalitetit kroat. Ata e kanë marrë të ndjerin nga Shtëpia e Shëndetit në Slunj, me arsyetimin e rrejshëm se një numër i madh i serbëve të plagosur në Cetingrad kanë nevojë për ndihmë dhe e kanë dërguar në parkingun e restorantit *Suzi* në Mali Vukoviq. Në momentin kur mjeku është nisur në drejtim të objektit, në të është shtënë shumë herë nga largësia prej disa metrash - Pashiqi ka shtënë nga pushka automatike, ndërsa Grubjeshiqi nga revolva e kalibrit 7,62 mm.

Shqyrtimi kryesor ka filluar më 01.02.2008 para trupit gjykues të cilin e udhëhiqte gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq<sup>8</sup> dhe deri në marrjen e vendimit janë mbajtur shtatë seanca gjyqësore. Janë dëgjuar tetë dëshmitarë, tre nga të cilët dëshmitarë të mbrojtur që kanë dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun, si dhe është lexuar deklarata e të dëmtuarës Ana Krushiq, të cilën e ka dorëzuar gjykata e Kroacisë, përderisa një ekspert ka paraqitur konstatimin dhe mendimin e tij. Para gjykatës kanë dëshmuar edhe dëshmitarët nga Kroacia, që është rezultat i bashkëpunimit të mirë të gjyqësorit serb dhe atij kroat. Një nga ata është Milan Grubjeshiq, i cili tashmë është dënuar për këtë veprë penale në Kroaci. I akuzuari e paraqiti mbrojtjen e tij, nuk ishte penduar dhe u deklarua i pafajshëm.

Gjykimi është zhvilluar në përputhje me standardet profesionale dhe të drejtësisë. Ishte efikas dhe dinamik. Megjithatë, dënimi i shqiptuar ndaj Zdravko Pashiqit është minimal nëse merren parasysh rrethanat dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, posaçërisht nëse merret parasysh se motivi për kryerjen e vrasjes është urrejtja kombëtare, kurse i ndjeri Krushiq, si mjek që ishte, gëzonte mbrojtje të posaçme sipas dispozitave të Konventës së Gjenevës. Gjykata u dha rëndësi të tepër rrethanave lehtësuese në anën e të akuzuarit, posaçërisht faktit se ai është invalid lufte. Pësia e veprës penale, motivet dhe mënyra e kryerjes janë të atilla që rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh nuk mund të arsyetojnë një dënim kaq të butë.

### **1.2.2. Rasti Kolona e Tuzllës**

Gjykimi ndaj Ilia Jurishiqit të akuzuar për veprë penale të përdorimit të formave të ndaluara të luftës, nga neni 148 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të LP të RSFJ-së, filloi para trupit gjykues për krime të luftës të cilin e kryeson gjykatësja Vinka Beraha-Nikiqeviq<sup>9</sup>, më 22.02.2008. Aktakuza e Prokurorisë për krime të luftës e ngarkon Ilia Jurishiqin se më 15 maj të vitit 1992, në cilësinë e eprorit të grupit operativo-komandues, të formuar pranë Qendrës për Siguri Publike dhe të emëruar si «Shtabi Operativ» me

<sup>8</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë gjykatësja Vinka Beraha-Nikiqeviq dhe gjykatësi Vesko Krstajiq.

<sup>9</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq dhe gjykatësi Vesko Krstajiq.

autorizime për t'u dhënë urdhra të gjitha formacioneve të armatosura në rajonin e Tuzllës, në kundërshtim me marrëveshjen e arritur më herët mes Bosnjë Hercegovinës dhe RFJ-së për tërheqjen paqësore të APJ-s nga territori i Bosnjë e Hercegovinës në territorin e Republikës Federale të Jugosllavisë, e si rezultat edhe në kundërshtim me marrëveshjen e arritur paraprakisht në mes të përfaqësuesve të autoriteteve civile dhe atyre ushtarake në Tuzëll, ka dhënë urdhrin e drejtpërdrejt për sulmin mbi kolonën e APJ-së, duke shfrytëzuar kështu një mënyrë të palejuar të luftës, të ndaluar sipas të drejtës ndërkombëtare. Me këtë rast janë privuar nga jeta të paktën 92 pjesëtarë të APJ-së, kurse të paktën 33 pjesëtarë të tjerë të APJ-së janë plagosur.

Nga fillimi i shqyrtimit kryesor janë mbajtur gjithsej 16 seanca gjyqësore dhe janë dëgjuar 36 dëshmitarë, nga të cilët 26 ishin dëshmitarë-të dëmtuar. Në mesin e personave të dëmtuar, dëshmoi edhe dëshmitari i mbrojtur A. Edhe pse deri më tani ka dëshmuar një numër i madh i dëshmitarëve të dëmtuar, gjykata e ka të vështirë t'i gjejë emrat e të gjithë ushtarëve të vrarë ose të plagosur, prandaj duket se nuk do të jetë e mundur të gjenden të gjithë të dëmtuarit dhe të ftohen për të dëshmuar në seancën kryesore.

Menjëherë pas arrestimit të Ilija Jurishiqit në aeroportin e Beogradit, më 11.05.2007, Ministria e Drejtësisë e Bosnjë Hercegovinës ka kërkuar dorëzimin dhe transferimin e lëndës kundër tij<sup>10</sup>, duke u thirrur në nenin e 30-të Konventës Evropiane mbi Bartjen e Procedurës në Çështjet Penale, nënshkruese të së cilës janë si Serbia ashtu edhe B. e H.-ja, por trupi gjykues për krime të luftës pranë Gjykatës së Qarkut në Beograd e ka refuzuar kërkesën, duke mos dorëzuar asnjë akt zyrtar për këtë vendim. Prokuroria për krime të luftës ka publikuar në media aktakuzën kundër Ilija Jurishiqit me datë 09.11.2007, para se të përfundojë hetimi. Po atë ditë, Prokuroria e B. dhe H.-së me kërkesë të Gjykatës së Qarkut në Beograd -Kolegjit për krime të luftës, i ka dëgjuar dëshmitarët e këtij procesi në prezencë të gjykatësit hetues të Kolegjit për krime të luftës së Gjykatës së Qarkut në Beograd, Milan Dilpariqit, dhe zëvendës Prokurorit për krime të luftës, Dragoljub Stankoviqit.

Ngritja e aktakuzës para përfundimit të hetimeve dhe refuzimi këmbëngulës i organeve të drejtësisë së Serbisë që lëndën t'ia kalojnë organeve të Prokurorisë së B. e H.-së, e cila gjithashtu është duke zhvilluar hetime në lidhje me këtë ngjarje, vërteton se rasti *Kolona e Tuzllës* është zgjedhur për t'i treguar publikut se Prokuroria për Krime të Luftës kujdeset për viktimat serbe. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2008 seancat gjyqësore janë caktuar një ose dy herë në muaj, me çka ky gjykim është trajtuar si i dorës së dytë. Gjykimi po zvarritet pa nevojë, kurse edhe seancat e mbajtura nuk po shfrytëzohen për vërtetimin e provave materiale. Gjithashtu, dëshmitarët-të dëmtuarit shpeshherë nuk lajmërohen në gjykatë, qoftë për shkak të pamundësisë së gjykatës për t'i përcaktuar adresat e tyre, qoftë për shkak të mosinteresimit të dëshmitarëve për të marrë pjesë në proces.

---

<sup>10</sup> “Nëse secili shtet që është palë në këtë marrëveshje, para ose gjatë procedurës penale për një vepër penale, e cila nuk mund të konsiderohet as vepër penale me natyrë politike, e as me natyrë të pastër ushtarake, informohet se një procedurë që zhvillohet në një shtet tjetër ka të bëjë me të njëjtën vepër penale ndaj të njëjtit individ, do ta shqyrtojë mundësinë e heqjes dorë apo ndërprerjes së procedurës së vet, apo t'ia përcjellë atë shtetit tjetër», neni 30 i Konventës Evropiane për Bartjen e Procesit në Çështjet Penale.

Karakteristikë e këtij procesi është se, ashtu si qëndrojnë punët tani, në gjykimin që po zhvillohet në Beograd nuk është e mundur të vërtetohet mbrojtja e të akuzuarit Jurishiq. Dëshmitarët që do të mund t'i vërtetonin apo mohonin pohimet e të akuzuarit, nuk duan të vijnë në Beograd. Në gjykatë po dëgjohen në cilësinë e dëshmitarëve apo palëve të dëmtuara vetëm ish ushtarët e APJ-së të cilët nuk dinë asgjë për aktivitetet e të akuzuarit gjatë kohës së ngjarjes të përshkruar në aktakuzë. Kjo e shton edhe më shumë dyshimin se gjykimi praktikisht është iniciuar për arsye politike, e jo për përcaktimin e përgjegjësisë së të akuzuarit për krimin e kryer në Tuzëll.

Përkundër faktit se në disa procedura tjera pranë kësaj gjykate të akuzuarit po mbrohen në liri, z. Jurishiq vazhdon të mbahet në paraburgim edhe pse mbrojtja ka propozuar disa herë heqjen e paraburgimit, duke ofruar të gjitha garancitë e nevojshme. I akuzuari ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur, por është deklaruar se ndihet fajtor. Në të vërtetë, duke kundërshtuar pohimet e aktakuzës se ai ka dhënë urdhrin për sulmin ndaj kolonës së APJ-së, i akuzuari ka deklaruar se ai vetëm e ka përcjellë urdhrin e komandantit të Sektorit të Sigurimit Publik (SSP) të Tuzllës, Mehmed Mehës – Bajriqi, i cili ka thënë ; “*zjarrit përgjigjuni me zjarr*“, pasi ka marrë informata se ushtarët e APJ-së po gjuajnë drejt objekteve dhe qytetarëve. Mbrojtja ka paralajmëruar se një prej provave materiale do të jetë xhirimi i emituar në televizionin lokal në Tuzëll, me rastin e shënimit të përvjetorit të çlirimit të Tuzllës, në të cilën Mehmed Bajriqi shpjegon se çka ka ndodhur dhe si e ka urdhëruar të akuzuarin Jurishiq që ta përcjellë urdhrin e përmendur. Kjo ishte prova kryesore gjatë procesit, sepse deri më tani dëshmitarët dhe të dëmtuarit e dëgjuar nuk kishin njohuri për përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

### **1.2.3. Rasti i Banski Kovačevićit**

Gjykimi kundër të akuzuarve Pane Bulati dhe Radeta Vranesheviq për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, nga nenin 142 paragrafi 1 i LP të RFJ-së, në lidhje me nenin 22 të RFJ-së, ka filluar më 2.09.2008 para trupit gjykues për krime të luftës me të cilin udhëheq gjykatësja Olivera Angjelković<sup>11</sup>. Aktakuza e Prokurorisë për krime të luftës e datës 16.04.2008, i ngarkon të akuzuarit se si pjesëtarë të Ushtrisë së Republikës Serbe të Krainës (RSK) në natën mes 22 dhe 23 marsit të vitit 1992, kanë vrarë gjashtë civilë të kombësisë kroate në Banski Kovačević. Bëhet fjalë për lëndën të cilën Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë ia dërgoi Prokurorisë për krime të luftës, në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim në procedimin e krimeve të luftës. Gjatë vitit 2008 kishte gjashtë ditë gjykim, ku u dëgjuan nëntë dëshmitarë. Disa prej dëshmitarëve kanë ardhur nga Kroacia ose janë dëgjuar nga ana e organeve kroate gjatë procedurës hetimore të akuzuarit e kanë mohuar fajin, duke akuzuar njëri tjetrin. Edhe pse të akuzuarit janë ballafaquar mes vete, sikurse që janë ballafaquar edhe të akuzuarit me shumicën e dëshmitarëve, roli i tyre konkret në ngjarje ka mbetur i pasqaruar. I akuzuari Bulat ndodhet në paraburgim, përderisa i akuzuari tjetër, Vranesheviq, mbrohet në liri.

---

<sup>11</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë gjykatësja Tatjana Vuković dhe gjykatësi Dragan Plaziniq.



#### 1. 2.4. Rasti Zvornik III

Gjykimi i Goran Saviqit dhe Sasha Qilerxhiqit, të akuzuar për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, të paraparë sipas nenit 142 paragrafi 1 të LP të RSFJ-së, në lidhje me nenin 22 të LP të RSFJ-së, ka filluar më 04.09.2008, para trupit gjykues për krime të luftës me të cilën kryeson gjykatësja Tatjana Vukoviq<sup>12</sup>. Aktakuza e Prokurorisë për krime të luftës i ngarkon ata se gjatë periudhës maj-korrik të vitit 1992 kanë kryer krime në pronën bujqësore *Ekonomia* dhe fabrikën *Ciglana* të Zvornikut. Prej fillimit të gjykimit e deri më tani janë mbajtur katër seanca në të cilat janë dëgjuar tre dëshmitarë, dy nga të cilët tashmë janë dënuar në lëndën e ndarë K.V. 5/08 (Ivan Koraq dhe Dragan Slavković). Të akuzuarit po mbrohen në liri. I akuzuari Saviq e ka mohuar fajin dhe ka deklaruar se kurrë nuk ka qenë në *Ekonomi* dhe *Ciglanë* dhe nuk ka parë myslimanë të mbajtur rob, por ka dëgjuar se robërit janë nxjerrë jashtë qytetit, në pronën bujqësore *Ekonomia*. I akuzuari Qilerxhiq gjithashtu është deklaruar i pafajshëm dhe ka pohuar se kishte dëgjuar për *Ciglanën*, por se nuk kishte qenë asnjëherë atje. Mendon se aktakuza ndaj tij është ngritur si pasojë e ngatërrimit të identitetit dhe se akuzat kanë të bëjnë me njeriun me të njëjtin emër, Sasha Qirković, i cili ishte pjesëtar i togut *Pivarski*.

#### 1.2.5. Rasti Skorpionët I

Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, i akuzuari Aleksandar Mediq, pjesëtar i njësisë *Skorpionët*, është dënuar me pesë vjet heqje lirie për shkak të ndihmës së dhënë gjatë kryerjes së krimeve të luftës kundër popullsisë civile. Gjykata Supreme e Serbisë e ka pranuar ankesën e mbrojtësve të të akuzuarit Mediq dhe e ka kthyer lëndën për rigjykim. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë kundër pjesëtarëve të njësisë *Skorpionët*, Gjykata Supreme e ka vërtetuar vendimin për lirimin e Aleksandër Vukovit, kurse Branislav Mediqit ia ka ulur dënimin nga 20 në 15 vite heqje lirie, edhe pse në bazë të provave është dëshmuar pa dyshim se si njëri ashtu edhe i akuzuari tjetër kanë marrë pjesë aktive në likuidimin e gjashtë myslimanëve.

Gjykimi i përsëritur kundër Aleksandar Mediqit për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, nga neni 142 paragrafi 1 i LP të RFJ-së, ka filluar më 15.10.2008, para trupit gjykues me të cilin ka udhëhequr gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq<sup>13</sup>. Aktakuza e Prokurorisë për krime të luftës e ngarkon Aleksandër Mediqin se ditën e papërcaktuar gjatë korrikut të vitit 1995, në vendin e quajtur Godinske Bare në afërsi të Tërnovës, në malin Treskavica (B e H), si pjesëtar i njësisë *Skorpionët*, u ka ndihmuar me paramendim pjesëtarëve të njësisë së tij që t'i privojnë nga jeta gjashtë persona të nacionalitetit myslimanë. Në vitin 2008 janë mbajtur dy seanca në të cilat është dëgjuar i akuzuari, i cili u deklarua i pafajshëm, si dhe një dëshmitar i prokurorisë.

Dëshmitari Slobodan Stojković, i cili e ka xhiruar ngjarjen inkriminuese, e ndryshoi dëshminë e tij. Ai në shqyrtimin kryesor gjatë gjykimit të parë kishte deklaruar se pasi personi i zënë rob iu përgjigj të akuzuarit Mediq se: “*ai nuk kishte shtënë (me armë)*” i akuzuari i tha se “*as edhe nuk do të kesh rastin të qëllosh*”, gjë që tregonte se i akuzuari e

<sup>12</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë gjykatësja Olivera Angjelković dhe gjykatësi Dragan Plaziniq.

<sup>13</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë Vinka Beraha-Nikiqeviq dhe gjykatësi Vesko Krstajiq.

dinte çka do të ndodhë me të. Dëshmitari e ndërroi deponimin e tij duke thënë se nuk e ka dëgjuar të akuzuarin Mediq të ishte shprehur në atë mënyrë. Në pyetjen pse e ka ndryshuar deklaratën, dëshmitari u përgjigj se herën e parë e kishte thënë atë që i ishte kujtuar, por pasi e ka rishikuar video-xhirimin e ngjarjes e ka kuptuar se nuk është ashtu. Deklarata e dhënë nga dëshmitari gjatë procesit hetimor dhe gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur për herë të parë është më e afërt me ngjarjen, më e besueshme dhe, për dallim nga dëshmia e fundit, ajo është bërë pa përgatitje paraprake dhe në bazë të asaj që atij i është kujtuar. Edhe pse dëshmitari Stojković e ndryshoi deklaratën, kjo nuk kishte rëndësi në përcaktimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit Mediq. I akuzuari ka dëgjuar, ose mund të ketë dëgjuar kur Pero Petrasheviq tha se: dy nga robërit do të vriten, kurse katër të tjerët do të lirohen. Edhe pse në video-xhirim duket se Petrasheviq këtë ia thotë personit të zënë rob, i cili po mbahej i shtrirë, pas kësaj dëgjohen komentet dhe të qeshurat e ushtarëve tjerë. Gjithashtu, nga xhirimi mund të shihet se i akuzuari i vështron dy robërit që po i bartin trupat e të vranëve. Ai qëndron anash dhe nuk proteston ndaj asaj që ka ndodhur. Ai shihet teksa përcjellë likuidimin e dy robërve të mbetur në vikendicë, e pastaj nisat ngadalë me të tjerët në drejtim të kamionit, duke mbajtur pushkën në sup. Aleksandar Mediq me asnjë fjalë, gjest apo veprim nuk dallon me nga të tjerët.

#### **1.2.6. Rasti Grubishno Polje**

Gjykimi i Bora Trbojeviqit për veprën penale krime kundër popullsisë civile, që sanksionohet sipas nenit 142 paragrafi 1 i LPJ-së, ka filluar më 26.09.2008, para trupit gjykues me të cilin udhëheq gjykatësja Snezhana Nikoliq-Garotiq<sup>14</sup>. Aktakuza e Prokurorisë për krime të luftës e datës 21.05.2008, e ngarkon të akuzuarin se në periudhën prej 13.08.1991 deri më 31.10.1991, në rrethinat e komunës së Grubishno Polje, si pjesëtar i të ashtuquajturës *Ardhat e Bilogradit*, ka marrë pjesë në sulme kundër popullsisë civile, marrjen, burgosjen dhe torturimin e robërve, në veprime çnjerëzore ndaj popullsisë civile dhe në vrasjen e civilëve. Gjykata e Zhupanisë në Bjellovar e dënoi në mungesë Pano Bulatin me 20 vite burgim. Bëhet fjalë për lëndën të cilën gjyqësia kroate ia la në dispozicion Prokurorisë për krime të luftës, në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim në procedimin e krimeve të luftës. Deri më tani janë mbajtur katër seanca gjatë të cilave janë dëgjuar nëntë dëshmitarë. I akuzuari, që gjatë kohës kritike ka qenë roje e burgut në objektin e shkollës ku po mbaheshin robërit kroat, në fshatin Velika Peratovica, deklaroi se nuk është fajtor dhe se nuk di se çka ka ngjarë me robërit pas tërheqjes së ushtrisë serbe dhe popullsisë nga fshatrat e komunës së Grubishno Poljes. Mbrojtja e tij bazohet në pretendimin se, sipas të gjitha gjasave, bëhet fjalë për ngatërrim të identitetit dhe se akuzat e bëra nga dëshmitarët kanë të bëjnë me Bozho Trbojeviqin, udhëheqësin e burgut.

#### **1. 2.7. Rasti i Kushninit**

Gjykimi i përsëritur ndaj të akuzuarve Zlatan Mançiq, Radeta Radojeviq, Danilo Teshiq dhe Mishel Seregi për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, ka filluar para Gjykatës së Qarkut në Nish, në shtator të vitit 2007. Me këtë gjykim kryeson

---

<sup>14</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë Vinka Beraha-Nikićević dhe gjykatësi Vesko Krstajiq.

gjykatësi Radomir Mladenović<sup>15</sup>. Aktakuza i ngarkon ata se në fillim të prillit të vitit 1999, data e saktë nuk dihet, kanë marrë pjesë në vrasjen e dy civilëve shqiptarë, në fshatin Kushnin të komunës së Prizrenit. I akuzuari Mançiq e ka urdhëruar të akuzuarin Teshiq dhe një ushtar tjetër që t'i privojë nga jeta dy shqiptarët, të cilët i janë dorëzuar atij si epror i organeve të sigurisë. I akuzuari Teshiq ia ka përcjellë urdhrin të akuzuarit Radivojeviq, ku ai dhe i akuzuari Seregi, duke vepruar në bazë të urdhrin, i kanë dërguar vëllezërit Miftar dhe Selman Temaj nga fshati Kushnin/Kušnin në drejtim të Prizrenit dhe i kanë privuan nga jeta me pushkë automatike, kurse trupat e tyre i kanë djegur pranë rrugës, rreth 4 km larg vendndodhjes së njësisë së tyre. Të akuzuarit Teshiq dhe Seregi e kanë pranuar kryerjen e veprës penale gjatë gjykimit të parë të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë. Gjykimi ka përfunduar me shpalljen e aktgjykimit dënues, por Gjykata Supreme e Serbisë e shfuqizoi vendimin me arsyetim se trupat nuk janë identifikuar dhe se Gjykata Supreme Ushtarake ka nxjerrur jashtë shqyrtimit kryesor një nga provat. Në gjykimin e përsëritur, të gjithë të akuzuarit e kanë mohuar veprën penale. Të akuzuarit Teshiq dhe Seregi tani mbrohen duke thënë se vëllezërit Temaj i kanë lënë të lirë rrugës për në Prizren, kurse janë mburrur kinse i kanë vrarë ata për të fituar prestigj brenda njësisë. Miftar Temaj është identifikuar në vitin 2004, në bazë të analizës së ADN-së, kurse ende po kërkohen mbetjet mortore të Selman Temajt.

Monitoruesi i FDH-së gjatë vitit 2008 përcolli një ditë të këtij gjykimi, në të cilën të akuzuarit Teshiq iu caktua paraburgimi për shkak të mosparaqitjes në gjykim. Tre të akuzuarit e tjerë po mbrohen në liri.

### **1.2.8. Rasti i Rahovecit**

Para trupi gjykues në Prizren, me seli në Pozharevc, me të cilin udhëheq gjykatësi Dushan Spasiq<sup>16</sup>, po zhvillohet procesi kundër dy pjesëtarëve të MPB-së së Serbisë, Boban Petkoviqit dhe Gjorgje Simiqit, për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, që sanksionohet sipas nenit 142 paragrafi 1 të LP të RFJ-së. Të akuzuarit ngarkohet se me datë 9.05.1999, kanë vrarë tre civilë shqiptarë në Rahovec: Ismail Durgutin dhe çiftin bashkëshortor Sezair dhe Shefkije Miftarin.

Gjykimi para trupit gjykues pesë-anëtarësh, me të cilin kryeson gjykatësi Dushan Spasiq, filloi më 5.12.2007. Gjatë vitit 2008 ka pasur dy ditë gjykim. Shqyrtimi kryesor është shtyrë për shkak të mos përgjigjes së të akuzuarve në thirrjet e gjykatës. Të akuzuarit mbrohen në liri dhe nuk i pranojnë thirrjet apo nuk përgjigjen në ftesat e marra, me çka e pengojnë procedurën. Gjykimi që po zhvillohet për të dytën herë para të njëjtit trup gjykues po zgjat tetë vite, pa pjesëmarrjen e të dëmtuarve. Fitohet përshtypja se sjellja e gjithë pjesëmarrësve në proces është e pashembullt dhe konformiste. Gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarve nga ana e trupit gjykues janë konstatuar një varg shkeljesh serioze të Ligjit mbi Procedurën Penale. Pas leximit të aktakuzës, kryetari i trupit gjykues nuk i pyeti të akuzuarit nëse e kuptojnë aktakuzën, edhe pse është i detyruar ta bëjë atë. Gjatë

<sup>15</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë: Marina Milanović dhe gjykatësit-porotë Olivera Ivanković, gjykatësja Ljiljana Parmaq, dhe gjykatësi Slobodan Jociq.

<sup>16</sup> Anëtarët e trupit gjykues janë gjykatësja Snezhana Vitosheviq dhe gjykatësit-porotë Ljubisha Neshiq, Spasoje Çojiq dhe Dobrila Krstev.

dëgjimit të të akuzuarit Petković, kryetari i trupit gjykues nuk insistoi që të akuzuarit të shpjegojë dallimin në deklaratën që e ka dhënë në këtë gjykim dhe asaj të bërë gjatë hetimeve. Edhe pse deklaratat e të akuzuarve nuk përputhen në elemente shumë qenësore, kryetari i trupit gjykues nuk ka kërkuar ballafaqimin e tyre.

### **1.2.9. Rasti Morina**

Sinan Morina është arrestuar në Mal të Zi, në bazë të urdhër arrestit të lëshuar nga MPB-ja e Serbisë, dhe i është dorëzuar Serbisë. Prokurori për krime të luftës ngriti aktakuzën kundër tij më 13.07.2005. Gjykimi filloi më 17.10.2007 dhe trupi gjykues që udhëhiqej nga gjykatësja Olivera Angjelković<sup>17</sup> e liroi atë nga akuzat më 20.12.2007. Morina është liruar nga akuzat se është pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale krime të luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 paragrafi 1 i LPJ-së, në lidhje me nenin 22 të LPJ-së. Aktakuza e ngarkonte atë se gjatë periudhës prej 17 deri më 21 korrik të vitit 1998, me qëllim që ta detyrojë popullsinë serbe të largohet nga territori i komunës së Rahovecit/Orahovac, ka ndërmarrë sulme të armatosura që kishin për pasojë vdekjen e disa personave. Në barrë i vihej se kishte bërë burgosje të kundërligjshme, torturime dhe shkelje të integritetit trupor, përderisa anëtarët e njësisë së tij [Ushtria Çlirimtare e Kosovës] kanë kryer vrasje, dhunime dhe shkatërrime të pronës private dhe objekteve të kultit. Në arsyetimin e vendimit, kryetarja e trupit gjykues ka theksuar se aktakuza është shumë e përgjithësuar dhe se prokurori nuk ka dëshmuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Në shqyrtimin kryesor, dëshmitarja-e dëmtuara Slavica Banziq e ka përshkruar ngjarjen ndryshe nga se e kishte treguar para gjykatësit hetues, ndërsa djali i saj [dëshmitari Milan Banziq] i ka përmendur emrat e shqiptarëve të cilat ia kishte treguar e ëma menjëherë pas ngjarjes, por jo edhe emrin e Sinan Morinës, kurse dëshmitarët-të dëmtuarat tjera nuk e kanë vërtetuar se Slavicën dhe gratë tjera i kanë rrahur pjesëtarët e UÇK-së gjatë arrestimit të tyre në Opterushë/Opteruša. Lënda ndodhet në Gjykatën Supreme të Serbisë, me qëllim që të vendoset për ankesën e prokurorit në vendimin e shkallës së parë. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata Supreme e Serbisë ende nuk kishte marrë vendim në lidhje me këtë rast.

## **2. Monitorimi i gjykimeve për krime të luftës dhe vepra penale të motivuara etnikisht në Kosovë**

FDH – Kosovë gjatë vitit 2008 ka përcjellë 11 gjykime për krime të luftës dhe vrasje me prapavijë politike dhe etnike [gjithsej 59 ditë gjykim], të cilat janë zhvilluar pranë Gjykatave të Qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pjesa dërmuese e proceseve kanë filluar në vitin 2007, përderisa gjatë vitit 2008 kanë filluar gjykimet vetëm për dy raste: *Prokurori kundër Osman Zyberajt dhe Shyqeri Shalës dhe Prokurori kundër Marko Simonoviqit*. Procesi i zhvilluar në shkallën e parë kundër të akuzuarve Osman Zyberajt dhe Shyqeri Shalës ka përfunduar, përderisa në rastin kundër të akuzuarit Marko Simonoviqit është mbajtur vetëm një ditë gjykim.

---

<sup>17</sup> Anëtarë të trupit gjykues ishin gjykatësja Tatjana Vuković dhe gjykatësi Vesko Krstajić.

Një nga arsyet për numrin e vogël të gjykimeve të reja qëndron në vet procesin e bartjes së kompetencave në fushën e sundimit të ligjit nga administrata e UN-it [UNMIK] në misionin e UE-së [EULEX], gjë që ka ndodhur më 9 dhjetor 2008. Për këtë arsye, në gjysmën e dytë të vitit 2008 shqyrtimet kryesore as që janë caktuar, por janë mbajtur vetëm mbledhjet e gjykatësve të caktuar, ku është vendosur në lidhje me vërtetimin e aktakuzës apo burgosjen e të akuzuarve. Në vitin 2008 ende nuk janë shpallur datat e përsëritjes së gjykimit për tri lëndët, të cilat me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës janë kthyer për rigjykim në shkallën e parë: *Prokurori kundër Latif Gashit dhe të tjerëve* (vendim i gjykatës së shkallës së parë është marrë më 16.06.2003, vendimi i shkallës së dytë më 8.07.2005, kur të akuzuarit janë liruar nga burgimi me një vendim të posaçëm); *Prokurori kundër Angjelko Kolashincit*, (vendimi i shkallës së parë më 31.01.2003, vendimi i shkallës së dytë - Gjykatës Supreme - e ktheu lëndën për përsëritje të gjykimit më 09.01.2004, kur i akuzuari u lirua me vendim të posaçëm); *Prokurori kundër Shefqet Musliut* (vendimi i shkallës së parë është marrë më 26.04.2004, vendimi i shkallës së dytë është marrë më 27.03.2007, përderisa i akuzuari gjendet në paraburgim prej 07.07.2003). Është shqetësuese praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës që t'i zvarrisë lëndët e shqyrtuara të cilat kanë përfunduar në shkallën e parë shumë vite më parë. Ka gjashtë lëndë të tilla: *Prokurori kundër Sadri Shabanit dhe të tjerëve* (vendimi i shkallës së parë është marrë më 19.05.2005, i akuzuari gjendet në paraburgim që nga marsi i vitit 2004.); *Prokurori kundër Mehmet Morinës* (vendimi i shkallës së parë është marrë më 22.07.2005, i akuzuari gjendet në paraburgim që nga marsi i vitit 2004); *Prokurori kundër Selim Krasniqit dhe të tjerëve* (vendimi i shkallës së parë është marrë më 10.08.2006, i akuzuari gjendet në paraburgim që nga shkurti i vitit 2004); *Prokurori kundër Jeton Kiqinës* (vendimi i shkallës së parë është marrë më 8.03.2007, i akuzuari gjendet në paraburgim që nga data 9.11.2004); *Prokurori kundër Esmin Hamzës dhe të miturit A.K.* (me vendimin e shkallës së parë të datës 15.06.2007, atij i është shqiptuar masa edukative e dërgimit në institucionin edukativo-korrektues të Lipljanit, në kohëzgjatje 2 vite)<sup>18</sup> dhe *Prokurori kundër Idriz Gashit* (vendimi i shkallës së parë është marrë më 22.06.2007, i akuzuari ndodhet në paraburgim nga maji i vitit 2006).

Aktakuzat e lëndëve të monitoruara nga FDH-ja janë ngritur dhe përfaqësuar ekskluzivisht nga prokurorët ndërkombëtarë. Gjithashtu, kryesuesi i të gjitha trupave gjykues si dhe anëtarët e tyre ishin gjithashtu gjykatësit ndërkombëtarë.

## **2. 1. Rasti Sadat Fejza**

Me datë 16.01.2008, Gjykata e Qarkut në Gjiilan/Gnjilane ka marrë dhe ka shpallur vendimin sipas të cilit i akuzuari Sadat Fejza është dënuar me gjashtë vite e gjashtë muaj heqje lirie, për veprën penale të vrasjes në tentativë, që sanksionohet nga neni 30 paragrafi 2, 3 dhe 4 i KPK-së, në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LPJ-së<sup>19</sup>.

Sipas vendimit të parë, i akuzuari Sadat Fejza, i cili është gjykuar në mungesë, është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë vite e

<sup>18</sup> Ligji për të Miturit e obligon gjykatën procedojë me procedurë të shpejtë.

<sup>19</sup> Zbatimi i këtyre ligjeve është paraparë me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut.

gjashtë muaj. Duke vendosur në bazë të ankesës së avokatit, Gjykata Supreme e Kosovës ia ktheu lëndën për rigjykim të njëjtës gjykatë.

Gjykimi i përsëritur ndaj të akuzuarit Fejza ka filluar më 7.9.2007, para trupit gjykues të përzier në Gjilan/Gnjilane, me të cilin kryesonte gjykatësi ndërkombëtar Maurizio Salustro<sup>20</sup>. Aktakuza e datës 26.01.2001 e ngarkonte Sadet Fejzën se me datë 12.07.2000, në rrugën regjionale Gjilan/Gnjilane – Viti/Vitina, në afërsi të fshatit Klllokot/Klokot, duke vepruar në bashkëpunim me persona të paidentifikuar, përmes sulmit të armatosur në veturën *Opel vectra* ka tentuar t'i privojë nga jeta tre serbë, klerikë ortodoks: Dragan Kojiqin, Branko Paloçeviqin dhe Zvonko Kostiqin.

Që nga fillimi i shqyrtimit kryesor janë mbajtur shtatë seanca gjyqësore në të cilat janë dëgjuar dy dëshmitarë-të dëmtuar dhe një dëshmitar i mbrojtjes. Gjatë vitit 2008 janë mbajtur dy seanca gjyqësore, në të cilat është dëgjuar një dëshmitar i mbrojtjes dhe është lexuar deklarata e dëshmitarit-të dëmtuarit Branko Palosheviqit, i cili në ndërkohë ka ndërruar jetë.

Gjykata Supreme e Kosovës më 30.07.2008 e ka vërtetuar vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilan, me çka procesi ka përfunduar në mënyrë të plotfuqishme. I dënuari Sadat Fejza gjendet në vuajtje të dënimit që nga dita e shpalljes së vendimit.

## **2.2. Rasti Miroslav Vučković**

Me datë 23 maj 2008, trupi gjykues ndërkombëtar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të cilin e kryesoi gjykatësja ndërkombëtare Lolita Dumlao<sup>21</sup>, e shpalli fajtor të akuzuarin Miroslav Vučković për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, sipas nenit 142 të LPJ-së, në lidhje me nenin 22 të LPJ-së dhe i shqiptoi një dënim të vetëm me burgim në kohëzgjatje prej tetë vitesh. I akuzuari është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej pesë vitesh për arsye se më 15 prill të vitit 1999, në bashkëpunim me të tjerët, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë të popullsisë shqiptare në fshatin Gushac/Gušavac ka djegur dhe plaçkitur shtëpitë e popullatës civile, përderisa nga prona e Abit Sahitit i ka marrë të gjitha gjërat e lëvizshme, mes të cilave edhe një kamion, si dhe një dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë viteve për shkak se më 15 prill 1999, në fshatin Gushac/Gušavac është sjellë në mënyrë të dhunshme, ia ka vënë zjarrin shtëpisë së Abit Sahitit dhe Xhevat Zekës me qëllim që të krijojë frikë të popullsisë shqiptare në mënyrë që ata të largohen nga fshati.

Gjykim i përsëritur për herë të tretë filloi më 16.08.2007. Prej rifillimit të procesit janë mbajtur 40 ditë gjykime, ku kanë dëshmuar 36 dëshmitarë dhe dy ekspertë. Në mbrojtjen e tij, i akuzuari ka mohuar akuzat duke u thirrur në invaliditetin dhe paaftësinë e tij fizike për t'u angazhuar në ushtri gjatë kohës së luftës në Kosovë. Gjatë procesit të paraqitjes së provave janë lexuar 12 deklarata të dëshmitarëve nga fazat e mëhershme të procesit.

---

<sup>20</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësi ndërkombëtar Alain Bloch dhe gjykatësi vendor Avdullah Ahmeti.

<sup>21</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësi ndërkombëtar Dennis Leubke dhe gjykatësi ndërkombëtar John Fields

Dëshmitarët e mbrojtjes që u dëgjuan gjatë këtij viti ishin kryesisht familjarët dhe shokët e të akuzuarit. Më dëshmitë e tyre ata i dhanë alibi të akuzuarit, duke pohuar se në periudhën kritike ai ishte në detyrë në vendin e tij të punës, punonte edhe pas orarit dhe nuk mund të largohej nga puna pa treguar për lëvizjet e tij. Deklaratat e dëshmitarëve të mbrojtjes dallonin sa i përket përshkrimit të gjendjes fizike të të akuzuarit. Karakteristikë për këtë gjykim është fakti se palët në procedurë kanë propozuar nga një ekspert, specialist të ortopedisë-traumatologjisë, gjetjet e të cilëve sa i përket gjendjes fizike të të akuzuarit ishin të ndryshme.

I akuzuari mbrohet në liri dhe nuk ishte prezent me rastin e shpalljes së vendimit. Ai ndodhet ende në liri, përkundër faktit se i është shqiptuar dënimi në kohëzgjatje më të lartë se pesë vite<sup>22</sup>.

Për shkak të ndërprerjes së punës së Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/ Mitrovica, gjykimi ka vazhduar në hapësirat e International Justice Support Department (IJS), në objektin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë/Priština, në fillim të marsit të vitit 2008. Disa herë gjatë shqyrtimit kryesor është bërë ndërrimi i prokurorit dhe gjykatësve të trupit gjykues, por që nuk ka ndikuar në efikasitetin dhe dinamikën e gjykimit. Gjatë shqyrtimit kryesor prokurori ka paraqitur propozim për arritjen e marrëveshjes në mes të Prokurorisë dhe të akuzuarit, sipas të cilit Prokuroria do të ndërronte aktakuzën, por që akoma do të thirrej në veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, përderisa i akuzuari do ta pranonte fajin, kurse gjykata në këtë rast do t'i shqiptonte vendimin për dënim me burgim, i cili do ta përfshinte edhe kohën të cilën i akuzuari e kishte kaluar në paraburgim [ pesë vite, minimumi i dënimit për këtë vepër penale]. Negociatat kanë zgjatur katër ditë dhe janë zhvilluar në mes të prokurorit dhe të akuzuarit e avokatit të tij, në seanca të mbyllura. Negociatat i ndërpreu trupi gjykues me paralajmërimin se institucioni i marrëveshjes mes palëve në procedurë nuk është i njohur në drejtësinë kosovare, kështu që çfarëdo marrëveshje e palëve nuk është detyruese për trupin gjykues dhe se ajo do të vendos në bazë të fakteve të konstatuara gjatë shqyrtimit kryesor. Sipas mendimit të monitoruesve të FDH-Kosovë, trupi gjykues që në fillim është dashur t'i paralajmërojë palët se marrëveshja nuk është detyruese për gjykatën dhe të mos lejonte negociata në mes të palëve.

### ***2.3. Rasti Skender Islami dhe të tjerët***

Më 25 janar të vitit 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština ka shpallur vendimin me të cilin dënohen të akuzuarit me nga një dënim unik me burgim, si vijon: i akuzuari Skender Islami dënohet me burgim në kohëzgjatje prej tetë vitesh, Mustafë Islami me 7 vite burgim, Ramadan Islami me 3 vite burgim, Omer Sylejmani me 3 vite burgim dhe Gazmend Morina me 2 vite burgim. Vendimi i obligon të akuzuarit Skender Islamin, Mustafë Islamin dhe Gazmend Morinën që t'ia kompensojnë të dëmtuarit Miroslav Veličkoviçit dëmin e shkaktuar material në lartësi prej 50.000 eurosh, kurse të akuzuarit Mustafë Islami, Ramadan Islami dhe Omer Sylejmani obligohen t'ia kompensojnë dëmin

---

<sup>22</sup> Neni 353 paragrafi 1i KPP-së: Në rastet kur shqiptohet vendimi me të cilin i akuzuari dënohet me pesë vite burgim apo dënim më të rëndë, trupi gjykues do të urdhëroj që i akuzuari të paraburgoset, nëse nuk gjendet në paraburgim.

të dëmtuarit Milomir Mitroviq në lartësi prej 20.000 eurosh. I akuzuari Skender Islami është i obliguar që të dëmtuarit Grujica Simiqit t'ia kompensojë dëmin material në lartësi prej 3 000 eurove.

Aktakuza e datës 16.02.2007 i ngarkon të akuzuarit se më 17 dhe 18.03.2004 [gjatë trazirave të marsit që ndodhën në vitin 2004] në fshatin Bresje, komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, kanë djegur restorantin *Zhivin gaj* dhe shtëpinë e serbit Miroslav Veličkoviq, kioskun që ndodhet pranë shtëpisë së tij pronë e Stojanka Zoriqit, *Spitalin rus*, Shtëpinë e Shëndetit, barnatoren, ndërtesën e shkollës fillore „*Sveti Sava*“ dhe postën në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, si dhe disa vetura të parkuara para spitalit dhe Shtëpisë së Shëndetit, pronarët e të cilëve ishin kryesisht serbë, me çka kanë kryer vepra penale të pjesëmarrjes në grupin që kryen vepra penale, nga neni 2000 paragrafi 2 i KPK-së, vepër të rëndë kundër sigurisë publike, nga neni 164 paragrafi 1 i KPK-së dhe nxitjes së urrejtjes, përçarjes dhe mos durimit nacional, racor dhe fetar, sipas nenit 1 paragrafit 1.1 dhe 1.2. të Rregullores së UNMIK-ut 2000/4 mbi Ndalimin e nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit, kombëtar, racor, fetar dhe etnik. Ta akuzuarit deklaruan se ndihen të pafajshëm.

Shqyrtimi kryesor para trupit gjykues ndërkombëtar me të cilin kryesonte gjykatësi ndërkombëtar Alain Bloch<sup>23</sup>, filloi me datë 22.10.2007. Në vitin 2008 janë mbajtur gjashtë ditë gjykim, ku janë dëgjuar të akuzuarit, pesë dëshmitarë, mes të cilëve edhe përfaqësuesi i objektit të dëmtuar të PTT Serbia, dy dëshmitarë janë dëgjuar për herë të dytë me qëllim që t'i precizojnë deklaratat e tyre të mëhershme, është lexuar deklarata e njërit nga dëshmitarët nga procesi i mëparshëm dhe janë kryer tri ballafaqime të dëshmitarëve – policë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) - me dëshmitarët e mbrojtjes. Për shkak të dyshimit të bazuar se kanë dëshmuar në mënyrë të rrejshme janë bërë tetë fletëparaqitje penale kundër dëshmitarëve në këtë proces. Me një rast, kryetari i trupit gjykues, në kundërshtim me nenin 164 paragrafin 1 të KPPK-së, nuk i ka larguar dëshmitarët nga gjykatorja gjatë kohës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tjerë, edhe pse këtë është dashur ta bëjë.

#### **2.4. Rasti i Albin Kurtit**

Gjykimi kundër të akuzuarit Albin Kurt për veprat penale: pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, të parapara me nenin 318 paragrafi 1 të KPPK-së, thirrje për rezistencë, nga neni 319 paragrafi 1 i KPPK-së dhe pjesëmarrje në grupin që kryen vepra penale në tentativë nga neni 320 paragrafi 1 i KPPK, në lidhje me nenin 20 të KPPK-së, filloi më 19.09.2007, para trupit gjykues ndërkombëtar me të cilin kryeson gjykatësi Maurizio Salustro<sup>24</sup>. Sipas asaj që thuhet në aktakuzën e ngritur më 31.05.2007, i akuzuari Albin Kurti i ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë më 10 shkurt të vitit 2007, gjatë demonstratave të lëvizjes *Vetevendosje/Samoopredeljenje*, në Prishtinë/Priština. Pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut gjatë këtyre demonstratave kanë

<sup>23</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësi ndërkombëtar Tron Gundersen dhe gjykatësi ndërkombëtar Dennis Luebke.

<sup>24</sup> Anëtarët e trupit gjykues janë gjykatësit ndërkombëtar John Fiels dhe Koster Noster.



plagosur rëndë me plumba të gomës dy pjesëtarët të kësaj lëvizjeje, të cilët kanë ndërruar jetë të nesërmen në spital, si pasojë e plagëve të marra.

Gjatë vitit 2008 janë mbajtur tri ditë gjykim, ku janë shqyrtuar çështje që kanë të bëjnë me procesin. I akuzuari Kurti ka bërë vërejtje në lidhje me përbërjen e trupit gjykues dhe disa herë e ka refuzuar mbrojtjen nga avokati i caktuar sipas detyrës zyrtare. Meqenëse bëhet fjalë për veprë penale për të cilën është paraparë mbrojtja e detyruar, shqyrtimi kryesor është dashur të ndërpritet. Në lidhje me këtë vendim, gjykata e ka informuar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës, departamentin për Drejtësi të UNMIK-ut dhe Gjykatën Supreme. Shqyrtimi kryesor nuk ishte caktuar deri në fund të vitit 2008. Sipas informatave të cilat FDH-Kosovë i ka marrë nga shefi i gjykatësve ndërkombëtar pranë misionit të OKB-së në Kosovë, Vinoda Boolell, procesverbalet e kësaj lënde i janë dorëzuar Misionit të EULEX-it në Kosovë.

### ***2.5. Rasti Osman Zyberaj dhe Shyqeri Shala***

Më datë 17.04.2008, Gjykata e Qarkut në Prizren shpalli aktgjykimin sipas të cilit të akuzuarit Osman Zyberaj dhe Shyqeri Shala shpallen fajtor dhe dënohen me nga një dënim të vetëm me burgim në kohëzgjatje prej 25 vjetësh, për shkak të veprave penale: vrasje e rëndë nga neni 147 paragrafët 4, 5 dhe 8 të KPPK-së, vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 11 i KPPK-së, në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së, të kryera në bashkëveprim, dhe mbajtjes së paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së. Aktakuzën e ngriti prokurori ndërkombëtar Robert Dean, me datë 16.07.2007.

Të akuzuarit janë dënuar për shkak se më 10 tetor të vitit 2005 në bashkëveprim kanë shtënë dhe e kanë vrarë Hasan Rustemin, kurse e kanë plagosur rëndë Nazim Rustemin, në tregun e gjelbër të fshatit Xërxë/Zrze. Të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me armë të pidentifikuar. Me rastin e arrestimit, më 19.04.2005, Osman Zyberaj i është gjetur në posedim arma e zjarrit, revolveri *Amadeo Rossi* dhe pesë plumba, për pronësinë, kontrollin, posedimin ose shfrytëzimin e të cilit nuk kishte leje. Osman Zyberaj është i afërm i Bedri Zyberaj, një nga të akuzuarit për rastin *Selim Krasniqi dhe të tjerët*<sup>25</sup>, ku pritej të dëshmonin Hasan dhe Nazim Rustemi, për shkak të vrasjes së vëllait të tyre Murat Rustemit, në vitin 1998. Është vërtetuar se me datë 10.10.2005 në ora 16:20, pak para ngjarjes kritike, të akuzuarit janë parë në tregun e gjelbër ku kanë mbërritur me veturën *Opel Ascona*, me të cilën e kanë bllokuar veturën e viktimave. Me datë 12.10.2005 e kanë kontaktuar gazetarin e gazetës ditore „Lajm“, Qemal Krasniqin, të cilit i kanë pranuar kryerjen e veprës penale.

---

<sup>25</sup> Procesi është zhvilluar para Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane për veprën penale të krimit të luftës kundër popullsisë civile. Sipas aktgjykimit të datës 10.08.2006, të akuzuarit Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj dhe Agron Krasniqi janë dënuar me shtatë vite heqje lirie, prokurori ka hequr dorë nga ndjekja penale kundër Xhavit Elshanit dhe Isuf Gashit.

Shqyrtimi kryesor para trupit gjykues ndërkombëtar me të cilin kryesonte gjykatësi Dennis Luebke<sup>26</sup>, ka filluar më 31.01.2008. Deri në marrjen e vendimit janë mbajtur dhjetë ditë gjykim. Shqyrtimi kryesor ka filluar në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Prizren/ Prizren, që pastaj të transferohet në gjykatoren speciale të burgut të *Dubravës*. Fillimin e gjykimit e kanë përcjellë më shumë se 50 njerëz, kryesisht anëtarë të familjeve dhe miq të të akuzuarve. Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar 17 dëshmitarë, mes të cilëve edhe dëshmitari-i dëmtuari Nazmi Rustemi, dëshmia e të cilit është zhvilluar pa prezencë të publikut, si dhe tre ekspertë. I akuzuari Osman Zyberaj u mbrojt në heshtje, përderisa i akuzuari Shyqëri Shala e ka mohuar fajësinë gjatë marrjes në pyetje.

Gjatë gjithë kohës sa është zhvilluar gjykimi, i akuzuari Zyberaj është ankuar nga shtypja e lartë e gjakut dhe gjendja e keqe shëndetësore, për ç'arsye e ka lëshuar gjykatoren pa lejen e gjykatës. Trupi gjykues i ka marrë parasysh ankesat e të akuzuarit duke e ndërprerë gjykimin për një kohë të shkurtër dhe duke i kërkuar personelit mjekësor që ishte prezent ta ekzaminojë dhe ta përcaktojë gjendjen shëndetësore të të akuzuarit. Sipas konstatimeve dhe mendimit të ekspertit, i akuzuari Zyberaj ishte në gjendje ta përcjellë gjykimin dhe ta kuptojë rëndësinë e tij, përkundër problemeve shëndetësore. Më në fund, trupi gjykues lejoi që i akuzuari Zyberaj ta përcjellë gjykimin nga shtrati medicinal që u mundësua të futet në gjykatore, gjë që e bëri gjykimin trivial dhe joserioz, si dhe e rrënoi reputacionin dhe dinjitetin e institucionit të gjykatës në sytë e publikut profesionist.

## **2.6. Rasti Florim Ejupi**

Trupi gjykues pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, i përbërë nga gjykatësit ndërkombëtar dhe i kryesuar nga gjykatësja Hajnalka Karpati<sup>27</sup>, me datë 6.06.2008 ka shpallur publikisht aktgjykimin më të cilin e dënon të akuzuarin Florim Ejupi me një dënim të vetëm me burgim në kohëzgjatje prej 40 vitesh për këto vepra penale: vrasje nga neni 30 paragrafi 1 dhe 2, pikat 1) 2) 3) dhe 5) të KPK-së, në lidhje me nenin 22 të LPJ-së; tentim vrasje të paraparë sipas nenit 30 paragrafit 2, 3 dhe 4 të KPK-së, në lidhje me nenin 19 dhe 22 të LPJ-së; terrorizëm nga neni 125 i LPJ-së; shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 157 paragrafi 3 i KPK-së; nxitje e urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, sipas nenit 134 të LPJ-së; dhe posedim i paautorizuar i armëve, sipas nenit 199 paragrafi 1 dhe 3 i KPK-së.

Me datë 17.05.2006<sup>28</sup>, prokurori ndërkombëtar Thomas Hickman ngriti aktakuzën kundër Florim Ejupit për shkak se më 16 shkurt 2001, në afërsi të fshatit Livadicë/Livadica, komuna e Podujevës/Podujevo, në bashkëveprim me persona tjerë të panjohur për prokurorinë, ka planifikuar dhe ka vendosur mjet eksploziv nën rrugë, në kanal in nëpër të cilën lëvizte konvoji i autobusëve me udhëtarë serbë nga Kosova/Kosovo, të cilët pas lufte jetonin si refugjatë në Serbi, e që po udhëtoni nga Nishi në drejtim të

<sup>26</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësit: Daniel Cailoux dhe John Fields.

<sup>27</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësi ndërkombëtar Noster Koster dhe gjykatësi ndërkombëtar Maurizio Salustro.

<sup>28</sup> Aktakuza pas vërtetimit është ndryshuar disa herë gjatë procesit, me datë 25.09.2007, 02.12.2007, 18.10.2007, nga lista e të vrarëve është fshirë një person, akuzën për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore e ka ri-kualifikuar në tentim vrasje.

Gračanicës/Gračanica, në Kosovë/Kosovo, ku duhej të merrnin pjesë në meshën për shpirtin e të vdekurve. Rreth orës 11:15 ka eksploduar autobusi i parë në konvoj, i cili pas hyrjes në territorin e Kosovës/Kosovo ishte nën përcjelljen e KFOR-it suedez. Në autobus ndodheshin 57 udhëtarë. Autobusin e goditi një sasi e madhe e eksplozivit, duke e ngritur atë lartë mbi tokë dhe duke e shkatërruar plotësisht pjesën e përparme të tij. Si pasojë e kësaj, vozitësi dhe udhëtarët që gjendeshin në pjesën e përparme të autobusit morën plagë vdekjeprurëse. Udhëtarët tjerë u lënduan, disa nga të cilët vdiqën më vonë, përkundër ndihmës mjekësore të ofruar.

Gjykimi filloi më 18.10.2007. Pas ndërprerjes së punës së Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, në shkurt të vitit 2008, gjykimi u transferua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priština. Që nga fillimi i shqyrtimit kryesor janë mbajtur 10 ditë gjykim ku janë dëgjuar gjashtë dëshmitarë, nga të cilët katër ishin dëshmitarë-të dëmtuar. Gjatë vitit 2008 janë mbajtur tetë ditë gjykim gjatë të cilave janë dëgjuar katër dëshmitarë, një nga të cilët dëshmitar i mbrojtur me pseudonimin *Alfa* dhe një ekspert. Gjatë procesit të vërtetimit të provave janë lexuar shtatëmbëdhjetë deklaratatë të dëshmitarëve, gjashtë nga të cilat i kanë dhënë dëshmitarët-të dëmtuarit. Mbrojtja nuk ka prezantuar dëshmi. I akuzuari është mbrojtur në heshtje.

Gjatë përcaktimit të dënimit, trupi gjykues është udhëhequr nga ligji që parasheh dënimin më të lehtë për të akuzuarin, ligj ky që ka qenë në fuqi gjatë kohës kur është kryer vepra penale. Dënimi i shqiptuar është adekuat me peshën e veprës së kryer. Ajo duhet të ketë edhe rol parandalues, t'i pengojë kryerësit e mundshëm nga përsëritja e veprave të ngjashme. Trupi gjykues gjatë marrjes së vendimit i ka marrë në konsideratë faktorët lehtësues: bëhet fjalë për një person të ri, të martuar, baba të dy fëmijëve të mitur, por të cilat nuk mund të ndikojnë në lartësinë e dënimit të shqiptuar. Për marrjen e vendimit dënues, vendimtare ka qenë dëshmia e dëshmitarit të mbrojtur *Alfa*. Përkundër faktit se trupi gjykues gjeti mospërputhje të caktuara në dëshminë e këtij dëshmitari, ato nuk ishin të asaj natyre që të mos pranohet dëshmia. Trupi gjykues e pranoi deklaratën e tij, në veçanti pjesën ku flitet për bisedat e dëshmitarit me Florim Ejupin në lidhje me sulmin kundër autobusit të *Nish-express-it*.

## **2.7. Rasti Gani Gashi**

Më 14 nëntor 2007, prokurorja ndërkombëtare Deborah Wilkinson ngriti aktakuzën kundër Gani Gashit për shkak të veprës penale të krimit të luftës kundër popullsisë civile, të paraparë me nenin 142 të LPJ-së. Aktakuza e ngarkon të akuzuarin se në korrik të vitit 1998, në rrugën në mes të fshatrave Komoran/Komorane dhe Kishnarekë/Kišna Reka ka vrarë shqiptarin Idriz Obrija, nga komuna e Glogocit/Glogovac, është përpjekur të vrasë Shpëtim Obrinë dhe u ka shkakuar lëndime të rënda trupore Halime dhe Selman Obrisë.

Në seancën për vërtetimin e aktakuzës, të mbajtur më 18 janar 2008 para gjykatësës ndërkombëtare Timothy Balandom, i akuzuari u deklarua se është i pafajshëm. Ai nuk e mohon se natën kritike ka shkrehur një plumb që ka goditur Idriz Obrinë, por qëllimi i tij nuk ka qenë të gjuajë në civilë, por në ushtarët armiq që kishin hapur zjarr.

Aktakuza është vërtetuar sipas të gjitha pikave. Gjatë vitit 2008 ende nuk kishte filluar shqyrtimi kryesor për këtë rast.

## **2.8. Rasti Skender Halilaj dhe të tjerët**

Trupi gjykues ndërkombëtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, nën kryesimin e gjykatësit Maurizio Salustro<sup>29</sup>, ka shqyrtuar më 20.05.2008 ankesat e avokatëve të dymbëdhjetë shqiptarëve kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane të datës 07.4.2005 dhe ka marrë vendim sipas të cilit të akuzuarit Skender Halilaj, Florim Kiqina, Zeqir Kiqina, Agim Xhylani, Bekim Morina, Adem Kiqina dhe Muharrem Xhemajli lirohen nga akuzat për vrasjen e familjes pesë-anëtarësh Hajra dhe veprat tjera penale të lidhura me rastin e vrasjes, përderisa të akuzuarit Skender Halilaj dhe Kimete Krasniqi, e cila është gjykuar në mungesë, u shpallën fajtorë për tentim vrasjen e Hamzë Hajrës në periudhën gjatë 14 dhe 15 majit të vitit 1998 dhe u dënuan me nga pesë vjet heqje lirie. E akuzuara Kimete Krasniqi është dënuar në mungesë me një vit heqje lirie për shkak të veprës penale të posedimit të paautorizuar të armëve. Asaj i është shqiptuar një dënim i vetëm në kohëzgjatje prej pesë vite e gjashtë muaj burgim. Sa u përket të akuzuarve tjerë, Burim Ramadanit, Arben Kiqinës, Arsim Ramadanit dhe Blerim Kiqinës, kundër tyre është vërtetuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ata janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për pesë vrasje me paramendim (vrasjen e Hamzë Hajrës, gruas së tij, Miradije Hajrës, si dhe fëmijëve të tyre Xhevdete Hajra, Mimoze Hajra dhe Adelina Hajra), si dhe për një tentim vrasje me paramendim (tentim vrasjen e Pranvera Hajrës). Në vendim konstatohet se të dënuarit këto vepra i kanë kryer në mënyrë tinëzore me datë 20.08.2001 rreth orës 23:00, duke u vënë pritën viktimave dhe duke shtënë në drejtim të tyre nga më shumë se një armë, përderisa ata po udhëtonin në automobilin e tyre, në rrugën mes fshatrave Biancë/Banjica dhe Tërstenik/Trstenik, komuna e Glllogocit/Glogovac. Burim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Arsim Ramadanit u janë shqiptuar dënime me nga 30 vite burgim, kurse Blerim Kiqinës dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 10 vjetësh.

Prokurori ndërkombëtar Thomas Hickman ka ngritur aktakuzën për shkak të vrasjes së pesë anëtarëve të familjes Hajra, tentim vrasjes së Pranvera Hajrës dhe disa vepra tjera të rënda penale të kryera më 20.08.2001, në Tërstenik/Trstenik, komuna Glllogoc/Glogovac, si dhe për shkak të tentim vrasjes së Hamzë Hajrës në vitin 1998. Gjykimi pranë shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane ka zgjatur prej 04.11.2003 deri më 07.04.2005, kur edhe është shpallur aktgjykimi. Të akuzuarit janë dënuar me këto dënime: Skender Halilaj, Burim Ramadanit, Arben Kiqina dhe Arsim Ramadanit me nga 30 vite burgim, Florim Kiqina 21 vite, Zeqir Kiqina dhe Blerim Kiqina 11 vite, Agim Xhylani, Bekim Morina, Adem Kiqina dhe Muharrem Xhemajli 4 vite dhe Kimete Krasniqi, e cila është gjykuar në mungesë, u dënua me 6 vite burgim.

## **2.9. Rasti Gani Hazeraj**

Më 20 dhjetor 2008, në Gjykatën e Qarkut në Prizren është mbajtur mbledhja për vërtetimin e aktakuzës, me të cilën ka kryesuar gjykatësja ndërkombëtare Lolita Dumlaio.

---

<sup>29</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësit Dennis Luebke dhe John Fields.

Aktakuza e prokurores ndërkombëtare Roberta Baldini, e datës 24 korrik 2008, e ngarkon të akuzuarin Gani Hazera, të njohur edhe si Gani Thaqi, për veprën penale të pjesëmarrjes në grupin që kryen vepra penale, nga neni 320 paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së dhe veprën penale të shtytjes, nga neni 24 i KPPK-së.

Aktakuza është vërtetuar sipas pikës 1, pjesëmarrje në grupin që kryen vepra penale, të sanksionuar sipas nenit 320 paragrafi 1 i KPPK-së

Shqyrtimi kryesor nuk filloi gjatë vitit 2008.

### **2.10. Rasti i të miturit S.M.**

Më 29 tetor të vitit 2008, para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština u mbajt mbledhja për vërtetimin e aktakuzës, me të cilën kryesonte gjykatësja ndërkombëtare Linn Slattengren.

Me aktakuzën e datës 12.08.2008, Prokurorja ndërkombëtare Maria Bamieh e ngarkon të akuzuarin S.M, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i mitur, për këto vepra penale: vrasje e rëndë e kryer në bashkëveprim me persona të tjerë që gjenden në arrati, nga neni 30 paragrafi 2, pikat 1), 2), 3) dhe 5) të Kodit Penal të Kosovës, vrasje e rëndë e mbetur në tentativë, sipas nenit 30 paragrafi 2 pikat 1), 2), 3) dhe 5) të Kodit Penal të Kosovës, në lidhje me nenin 19 të LPJ-së, si dhe pjesëmarrje në grupin që kryen vepra penale, nga neni 200 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës.

I akuzuari, i cili ndodhet në paraburgim nga data 25.09.2007, u deklarua i pafajshëm. Për shkak të rrezikut të ikjes, nuk u pranua kërkesa e avokatit të tij për ndërprerjen e paraburgimit.

Aktakuza është hedhur poshtë me vendimin e datës 10.11.2008.

Me datë 18.11.2008, prokurorja ndërkombëtare Marsha Mitchella ka ngritur propozim aktakuzën e re të cilin ia ka paraqitur Gjykatës për të Mitur në Prishtinë/Priština. Trupi gjykues për të mitur, të cilin e udhëhiqte gjykatësi ndërkombëtar Dennis Lueke<sup>30</sup>, e hapi shqyrtimin kryesor me datë 3.12.2008. Shqyrtimi kryesor ishte i mbyllur për publikun.

### **2.11. Rasti Gjeloš Krasniqi**

Gjykatësi i procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, Vinod Boolell, mbajti me datë 24.11.2008 seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit. Procedura paraprake zhvillohet kundër të akuzuarit Gjeloš Krasniqi, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer disa vepra penale dhe atë: krime të luftës kundër popullsisë civile, vrasje dhe tentim vrasje gjatë kohës së konfliktit të armatosur në Kosovë, në vitin 1999.

---

<sup>30</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësit Lolita Dumalo dhe Alain Bloch

Prokurorja ndërkombëtare Deborah Wilkinson ka propozuar në seancë zgjatjen e paraburgimit ndaj të akuzuarit, i cili është arrestuar më datë 28.05.2008. Prokurorja e arsyetoi gojarisht propozimin e saj të shkruar, duke thënë se rrethanat tregojnë se në rast të lirimit nga paraburgimi ekziston rrezik që i akuzuari të largohet nga Kosova, se kundër tij ekziston dosje kriminale në perëndim, që tregon se ai edhe ma parë i është shmangur vuajtjes së dënimit, si dhe ekziston rreziku që i akuzuari të kryejë vepër tjetër penale ose të ndikojë në dëshmitarë.

Me vendimin e gjykatësit Vinod Boolell, të akuzuarit iu zgjat paraburgimi deri më 24.12.2008, e pastaj paraburgimi iu zgjat përsëri pa u mbajtur seancë tjetër.

Aktakuza ndaj tij u ngrit më 03.12.2008.

### **3. Gjykimet për krime të luftës në Mal të Zi**

Në vitin 2008, në Mal të Zi u formuan<sup>31</sup> dy kolegje speciale për gjykimin e lëndëve penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, korrupsionin, krimet e luftës dhe terrorizmin, njëri pranë Gjykatës së Lartë në Bjelo Polje dhe tjetri pranë Gjykatës së Lartë në Podgoricë. Të dy këto kolegje janë kompetente për procedimin e krimeve të luftës. Gjatë vitit 2008 ishin duke u zhvilluar katër hetime për krime të luftës dhe u ngritën dy aktakuza për vepra penale krime të luftës.

#### **3.1. Rasti Morinj**

Gjatë vitit 2008 pranë Gjykatës së Lartë në Podgoricë janë zhvilluar hetime ndaj Mlagjen Govedaricës, Zlatko Tarleas, Ivo Gojniqit, Shpiro Luçiqit, Ivo Menzalinës dhe Bora Gligiqit, pjesëtarë të ish Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ), për krime kundër civilëve kroatë e boshnjakë dhe robërve të luftës në llogorin Morinj, pranë Kotorit. Hetimi ka filluar në korrik të vitit 2007, në bazë të kërkesës së Prokurorit të Lartë Shtetëror. Gjatë hetimit, i cili ka zgjatur 13 muaj, janë dëgjuar 180 dëshmitarë, pjesa më e madhe e të cilëve janë dëgjuar pranë Gjykatave të Zhupanive në Dubrovnik, Split, Zagreb, Shibenik, Rjekë, Koprivnik, Sisak dhe Vukovar.

Pas përfundimit të hetimeve, më 15.08.2008, Prokurori i Lartë Shtetëror ngriti aktakuzën kundër të gjashtë oficerëve të APJ-së ndaj të cilëve u zhvilluan hetimet. Aktakuza i ngarkon ata se gjatë periudhës prej 03. 10. 1991 deri më 18. 08.1992 në të ashtuquajturën Qendra për pranimin e robërve në Morinj, pranë Kotorit, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në torturimin, sjelljen çnjerëzore dhe shkeljen e integritetit trupor të 169 civilëve dhe robërve kroatë e boshnjakë, të cilët janë sjellë nga rrethinat e Dubrovnikut dhe Hercegovinës. Të gjithë të akuzuarit gjenden në paraburgim, me përjashtim të Ivo Menzalinës i cili sipas të gjitha gjasave fshihet në Beograd. Shqyrtimi kryesor nuk ka filluar deri në fund të vitit 2008.

---

<sup>31</sup> Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit mbi Gjykatat „Gazeta zyrtare e Malit të Zi“, numër 22/2008 i datës 02.04.2008.

### ***3.2. Rasti Kalugjerski Laz***

Prokurori Special i Malit të Zi për krim të organizuar, Stojanka Radoviq, më 30.07.2008 ngriti aktakuzën kundër Predrag Strugarit, Momçilo Barjaktaroviçit, Petar Labudoviçit, Aca Knezheviçit, Branislav Radniçit, Boro Novakoviçit, Miro Bojoviçit dhe Radomir Gjurashkoviçit për shkak të veprës penale krime të luftës kundër civilëve shqiptar, në prill të vitit 1999, në Kalugjerski Laz, komuna e Rozhajës.

Të akuzuarit ngarkohen se në periudhës prej 18.04 deri më 21.05.1999, gjatë kohës së konfliktit të armatosur në Republikën Federale të Jugosllavisë, kanë vrarë në Kalugjerski Laz 23 civilë shqiptarë që kishin ikur në territorin e Malit të Zi<sup>32</sup>. Të gjithë të akuzuarit ndodhen në paraburgim, me përjashtim të Pavle Strugarit.

Gjykimi nuk kishte filluar deri në fund të vitit 2008.

### ***3.3. Rasti Bukovica***

Prokurori i Lartë Shtetëror paraqiti kërkesë për fillimin e hetimeve kundër shtatë ish pjesëtarëve të përbërjes rezervë të Ushtrisë së Jugosllavisë: Branimir Boroviçit, Slavisha Svrkotës, Radisha Gjukoviçit, Radmilo Gjukoviçit, Slobodan Cvetkoviçit, Milorad Brkoviçit, Gjoko Gogiqit, për shkak të dyshimit se kanë kryer krime të luftës kundër civilëve myslimanë gjatë viteve 1992 dhe 1993 në territorin e Bukovicës, komuna e Pljevljes. Gjatë vitit 2008, para Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje dhe para Gjykatës Kantonale në Sarajevë janë dëgjuar më shumë se 30 dëshmitarë përmes lutjes drejtuar organeve të drejtësisë së Bosnjës.

FDH-ja ka siguruar përfaqësues të autorizuar për viktimat ashtu që interesat e tyre në procedurën hetimore i ka mbrojtur avokati i FDH-së. Hetimi ka përfunduar në fund të dhjetorit. Aktakuza ndaj këtyre personave nuk është ngritur deri në fund të viti 2008.

### ***3.4. Rasti i deportimit***

Në shkurt të vitit 2006, pranë Gjykatës së Lartë në Podgoricë ka filluar hetimi në lidhje me deportimin e 83 myslimanëve të Bosnjës, të cilët në maj të vitit 1992, me fillimin e luftës në B. e H.-së, kishin kaluar në territorin e Malit të Zi. Pasi që policia malaziasë ua dorëzoi refugjatët myslimanë autoriteteve të Republikës Serbe, ata u dërguan në llogorin e Foçës, ku u humbet çdo gjurmë.

Hetimi është iniciuar kundër Milisav Markoviçit, ish ndihmës Ministër i Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Milorad Ivanoviçit, komandant i Qendrës së Sigurisë të

---

<sup>32</sup> Hetimi ka filluar në shkurt të vitit 2007 pranë Gjykatës së Lartë në Bijelo Polje, gjatë së cilës janë dëgjuar më shumë se 50 dëshmitarë.

Herceg Novit, Dushko Bakraçit, operativ i Sekretariatit për Siguri të Brendshme (SSB) në Herceg Novi, Milorad Shljivançanin, komandant i policisë, Branko Bujiçit komandant i Qendrës së Sigurisë, Damjan Turkoviçit, ndihmës komandant i Qendrës së Sigurisë në Beranë, për shkak të dyshimit se kanë kryer krime të luftës kundër popullsisë civile. Hetimi ka përfunduar më 25.06.2008, kurse deri në fund të vitit prokurori nuk ngriti aktakuzë. Në gusht të vitit 2008, hetimi ka filluar edhe kundër Radoje Radunoviç, komandant i Sigurimit Shtetëror në Herceg Novi dhe Sreten Glenxhe, komandant i Seksionit për siguri në Ulqinit.

Në dhjetor të vitit 2008, Prokurori i Lartë Shtetëror propozoi ngritjen e aktakuzës kundër Bozhidar Stojoviçit, komandant i Sigurimit Shtetëror në Ulqin. Deri në fund të vitit 2008, Kolegji Special i Gjykatës së Lartë në Podgoricë nuk mori vendim në lidhje me këtë kërkesë.

## **4. Monitorimi i gjykimeve për krime t luftës në Bosnjë e Hercegovinë**

### **4.1. Rasti Kravica**

Me datë 29.07.2008, kolegji hetues i Seksionit të I-rë për krime të luftës i Gjykatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, me të cilin kryesoi gjykatësi vendor Hilmo Vuçiniq<sup>33</sup>, shpalli aktgjykimin dënues për shtatë të akuzuarit, ish pjesëtarë të MPB-së së Republikës Serbe, për gjenocid ndaj myslimanëve të Srebrenicës. Për veprën penale të gjenocidit, që sanksionohet sipas nenit 171 të LP të Bosnjë dhe Hercegovinës, i akuzuari i parë Millosh Supara është dënuar me 40 vite burgim, Milenko Trifunoviç me 42 vite, Aleksandar Radovanoviç dhe Brana Xhiniç me nga 42 vite, Slobodan Jakovljeviç dhe Branislav Medan me 40 vite dhe Petar Mitroviç 38 vite, përderisa Velibor Maksimoviç, Dragisha Zhivanoviç, Milovan Matiç dhe Miladin Stevanoviç u liruan nga akuzat.

Gjykimi kundër 11 ish pjesëtarëve të MPB-së së Republikës Serbe ka filluar më 3 shkurt të vitit 2006. Ata akuzoheshin për veprën penale të gjenocidit të kryer në magazinën e Kooperativës bujqësore *Kravica*, në korrik të vitit 1995. Gjatë gjykimin, i cili ka zgjatur më shumë se dy vite, janë zhvilluar 121 seanca gjyqësore ku janë dëgjuar 129 dëshmitarë, prej të cilëve 7 dëshmitarë të mbrojtur, 11 ekspertë dhe janë prezantuar disa qindra prova materiale. Prova më e rëndësishme ishte deklarata e dëshmitarit të mbrojtur të prokurorisë *S4* dhe deklarata e të akuzuarit Petar Mitroviç, të cilën ai e kishte dhënë gjatë hetimeve. Dëshmitari i mbrojtur *S4* ishte dëshmitar okular i ngjarjes dhe përshkroi në detaje rolin e secilit nga të akuzuarit. Gjithashtu janë dëgjuar edhe të mbijetuarit e vetëm (dëshmitarët e mbrojtur *S1* dhe *S2*) të cilët nuk i njohën të akuzuarit, por kanë përshkruar në mënyrë të hollësishme atë që kishte ndodhur në hangarin e *Kravicës*.

Gjatë vitit 2008, monitoruesi i FDH-së përcolli 30 ditë të këtij gjykimi, gjatë të cilave u dëgjuan gjithsej 16 dëshmitarë. Mes tyre ishin dy dëshmitarë të mbrojtur dhe u ballafaquan tre dëshmitarëve të prokurorisë të cilët u ekzaminuan në mënyrë të tërthortë e që deklaratat e të cilëve janë lexuar dhe pranuar në vend të marrjes së drejtpërdrejt në

---

<sup>33</sup> Anëtarët e trupit gjykues ishin gjykatësit ndërkombëtar Brilman Paul Melchior dhe Fisher Shiren Avis



pyetje. Gjithashtu, pesë ekspertë kanë dhënë konstatimet dhe mendimet e tyre. Prej të akuzuarve u mor në pyetje Aleksandar Radovanoviq. Gjykata pranoi si provë deklaratat e të akuzuarve Miladin Stevanoviqit dhe Petar Mirtoviqit të dhëna gjatë hetimeve, dhe për këtë arsye më 21.05.2008 procedura është ndarë në mënyrë që t'u jepet mundësi të akuzuarve tjerë t'i marrin në pyetje dy të akuzuarit e përmendur, gjë të cilën mbrojtja nuk e ka shfrytëzuar. Pas ndarjes janë zhvilluar tre procese paralele dhe atë kundër Milosh Stuparit dhe tetë të akuzuarve të tjerëve, kundër Petar Mitrovicqit dhe kundër Miladin Stevanoviqit. Megjithatë, trupi gjykues i mori vendimet në seancë të përbashkët.

Kusht i domosdoshëm për klasifikimin e një veprë si gjenocid është ekzistimi i qëllimit gjenocidal. Dëshmitarët e mbrojtjes flisnin se nuk ka pasur kurrfarë plani të parapërgatitur për vrasjen e robërve boshnjakë, por vrasjet janë paraprirë nga një incident. Megjithatë, dëshmitë vërtetojnë në mënyrë të drejtpërdrejt përmbajtjen e aktakuzës se kishte një veprim të organizuar dhe sistematik të forcave serbe, sepse të gjithë dëshmitarët e thanë qartë se gjatë kohës kritike janë dërguar në rrethinat e Srebrenicës nga vende të ndryshme. Prokuroria ka arritur të tregojë qëllimin gjenocidal të të akuzuarve, sepse dëshmoi se ata e dinin që do të merrnin pjesë në çlirimin, respektivisht marrjen e Srebrenicës, çka nënkuptonte pjesëmarrje në përndjekjen e grave dhe fëmijëve boshnjakë dhe vrasjen e meshkujve, por nuk i dinin konkretisht detyrat e tyre në përmbushjen e këtij qëllimi.

Të akuzuarin Milosh Stupar aktakuza e ngarkon edhe sipas përgjegjësisë komanduese sepse ai ishte komandant i Çetës së II-të. Mbrojtja e tij u përpoq të dëshmojë se gjatë kohës kritike i akuzuari Stupar nuk ishte komandant dhe se ai është zëvendësuar nga oficeri i ri, Rado Çuturiq, para ngjarjeve, në korrik të vitit 1995, por trupi gjykues vërtetoi në bazë të deklaratave të dëshmitarëve dhe provave materiale se Çuturiq ishte vetëm zëvendës i komandantit në terren, gjë që nuk ndryshon statusin e të akuzuarit Stupar. Por, trupi gjykues nuk dëshmoi përtej dyshimit të arsyeshem se i akuzuari Stupar e dinte se njerëzit e tij do të kryenin krime, por për këtë mori vesh më vonë dhe nuk i ndëshkoi kryesit. Aktakuza e ngarkonte edhe Milenko Trifunoviqin në bazë të përgjegjësisë komanduese. Trupi gjykues theksoi se nuk mund të ketë përgjegjësi të dyfishtë, duke pasur parasysh faktin se i akuzuari veprën që i vihet në barrë e ka kryer si aktor i drejtpërdrejt, por e dhëna që në atë kohë ai mbante funksionin në fjalë paraqet rrethanë rënduese gjatë përcaktimit të dënimit.

Rrethana rënduese kishte edhe për të akuzuarit Brana Xhiniq dhe Aleksandar Radovanoviq, që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimeve më të larta. Brana Xhiniq ka vepruar në mënyrë mizore dhe të lig kur ka gjuajtur bomba në robërit të cilët nuk ishin në gjendje të ikin dhe të cilët vdiqën në vuajtje të mëdha, përderisa Radovanoviq i ka nxitur dhe inkurajuar të tjerët gjatë vrasjeve. Rrethana lehtësuese kishte për Petar Mitorivqin, i cili, edhe pse gjatë kohës së gjykimit u mbrojt në heshtje, gjatë hetimit e tregoi të vërtetën dhe për shkak se ai tani ka probleme psikike si rezultat i asaj që ka përjetuar, që tregon pendimin e tij. Sa u përket personave të liruar, trupi gjykues e pranoi mbrojtjen e Maksimoviqit, Zhivanoviqit dhe Stevanoviqit se gjatë kohës kritike ata nuk ishin në *Kravicë*, gjë që e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët e mbrojtjes, sikurse edhe dëshmitari i mbrojtur *S4*, përderisa për Milovan Matiqin është marrë parasysh parimi *in dubio pro reo*

(në rast të dyshimit favorizohet i akuzuari), sepse përgjegjësia e tij penale nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Rëndësia e këtij gjykimi qëndron në faktin se ky ishte gjykimi i parë për gjenocid në Bosnjë e Hercegovinë. Nëse ndonjë krim meriton dënimin më të rëndë, atëherë ky është krimi i gjenocidit, e sidomos në rastet kur kryhet duke shkaktuar një numër të madh të viktimave. Është vlarë grupi i pambrojtur i njerëzve dhe atë në mënyrën që fyen dinjitetin e çdo qenie njerëzore. Gjykimi para Gjykatës së B e H-së i ka përmbushur të gjitha standardet profesionale për t'u konsideruar gjykim i drejtë. Gjykata dëshmoi se është e gatshme dhe e aftë të gjykojë për veprat më të rënda penale dhe në një proces të komplikuar të kësaj natyre, i cili që nga fillimi është shoqëruar me një varg situatash të cilat është dashur të zgjidhen menjëherë. Procesi është ndërprerë për shkak të grevës së urisë së të akuzuarve të cilët kundërshtuan gjykimin në bazë të Ligjit ekzistues Penale të Bosnjë e Hercegovinë të vitit 2003 dhe kërkuan që të gjykohen sipas LP të RSFJ-së i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprave. Duke pasur parasysh se është hequr dënimi me vdekje, dënimi maksimal që mund të shqiptohet sipas LP të RSFJ-së është 20 vite heqje lirie, përderisa sipas LP të B. e H.-së kohëzgjatja e burgimit është deri në 45 vite. Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur në mënyrë të përgjegjshme duke mos e bartur përgjegjësinë në instancën e dytë dhe, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për zbatimin e LP të Bosnjë e Hercegovinës të vitit 2003, i ka dënuar të akuzuarit me burgim afatgjatë.

#### ***4.2. Rasti Rasheviq dhe Todoviq***

Trupi gjykues i Gjykatës së B. e H.-së, me të cilën ka kryesuar gjykatësi Hilmo Vuçiniq, me datë 28. 02.2008, ka marrë vendim me anë të së cilit të akuzuari Mitar Rasheviq dhe Savo Todoviq janë shpallur fajtor për veprën penale krim kundër njerëzimit, të cilin e kanë kryer në periudhën prej prillit të vitit 1992 deri në tetor të vitit 1994, në *KPD Foça*, në Foçë. I akuzuari Rasheviq është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej tetë vitesh e gjysmë heqje lirie, përderisa i akuzuari Todoviq është dënuar me dymbëdhjetë vite e gjysmë heqje lirie.

Kolegji hetues i TPNJ-së mori vendimin që lënda kundër Mitro Rasheviqit dhe Savo Todoviqit të përcillet në kompetencë të Prokurorisë së Bosnjë e Hercegovinës- Seksionit të I-rë për krime të luftës. Në bazë të KPP të B. e H-së dhe Ligjit për transferimin e lëndëve penale, Prokuroria e B. e H.-së ngriti aktakuzën e modifikuar për veprën penale krim kundër njerëzimit, sipas nenit 172 paragrafi 1, pika h) e LP të B. e H-së. Të akuzuarit Rasheviq dhe Todoviq janë ngarkuar se kanë kryer përndjekjen, vrasjen, torturimin, burgosjen dhe robërimin e myslimanëve të Bosnjës si dhe pjesëtarëve tjerë të nacionalitetit jo serb, të burgosur në qendrën ndëshkuese korrektuese (QNK) *Foça*, prej prillit të vitit 1992 deri në tetor të vitit 1994. Sipas aktakuzës, i akuzuari Rasheviq ishte komandant i rojeve, përderisa i akuzuari Todoviq ishte në drejtorinë e QNK *Foça*, përpos tjerash, prej prillit të vitit 1992 deri në gusht të vitit 1993 ai ishte në postin zëvendës drejtor. Aktakuza thekson se në periudhën e sipërpërmendur në QNK *Foça*, e cili i kishte të gjitha karakteristikat e llogorit, ishin burgosur në mënyrë të paligjshme rreth 700 të burgosur të nacionaliteteve të ndryshme jo serbe. Mitar Rasheviq ishte përgjegjës për të

paktën 37 roje të burgut, mbi të cilët kishte kontroll efektiv, përderisa Savo Todoviq, si personi i dytë në hierarki, kishte të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi të ngjashme me ato të drejtorit.

TPNJ-ja këtë lëndë e kaloi në kompetencë të Gjykatës së B. e H.-së, sipas rregullit *11bis*. Gjykata e B. e H.-së e pranoi aktakuzën e modifikuar dhe filloi shqyrtimin kryesor me datë 06.04.2007. Gjithsej janë mbajtur 27 ditë gjykime, gjatë të cilave janë dëgjuar 42 dëshmitarë, nga të cilët 37 dëshmitarë të mbrojtur, si dhe dy ekspertë. Shumica e seancave janë mbajtur në prezencë të publikut, ndërsa vetëm shtatë ditë gjykim, mes të cilave seancat ku janë diskutuar masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe dëshmitë e të akuzuarit Sava Todoviq, janë mbajtur në seanca të mbyllura. Numri më i madh i dëshmitarëve të Prokurorisë si dhe të mbrojtjes janë paraqitur me pseudonime dhe kanë dëshmuar edhe nën masa të caktuara të mbrojtjes, mes të cilave edhe me identitet të mbrojtur.

Gjatë vitit 2008 janë mbajtur 6 seanca, gjatë të cilave janë dëgjuar tre dëshmitarë të mbrojtjes, dy nga të cilët ishin të mbrojtur. Gjithashtu, u dëgjua i akuzuari Todoviq dhe gjatë një pjese të dëshmisë së tij publiku u përjashtua nga gjykatorja.

Gjykimi është zhvilluar duke respektuar parimin e gjykimit korrekt dhe të drejtë. Megjithatë, mbretëron përshtypja se drejtësia për viktimat nuk është vënë në vend dhe dënimet nuk janë adekuate me peshën e krimit. Trupi gjykues përcaktoi se për të akuzuarin Rasheviq ekzistojnë rrethana lehtësuese, të cilat kanë ndikuar në zbutjen e dënimit nën minimumin ligjor të paraparë për veprat e sipërpërmendura penale. Edhe pse trupi gjykues nuk e lidhi vendimin për zbutjen e dënimit me rrethanat lehtësuese të cilat i ka marrë në konsideratë, duket se në këtë ka ndikuar qëndrimi pozitiv i të gjithë dëshmitarëve të Prokurorisë sa i përket të akuzuarit Rasheviq, të cilët e kanë theksuar humanizmin dhe njerëzinë e tij si një nga arsyet që sot janë ende gjallë dhe kanë mundësi të dëshmojnë. Përpos Milorad Krnojelcit, i cili është dënuar me 15 vite burgim nga TPNJ si drejtor i KPD *Foça*, Rasheviqi dhe Todoviqi janë të vetmit persona që janë përgjigjur para drejtësisë për këto krime.

#### **4.3. Rasti Lashvanska dolina**

Më 29 prill 2008, trupi gjykues i Gjykatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, Seksioni i I-rë për krime të luftës, mori vendimin i cili e shpall fajtor të akuzuari Pashko Ljubiçiq dhe e dënon me burgim në kohëzgjatje prej 10 viteve. Vendimi i shqiptuar është rezultat i marrëveshjes për pranimin e fajit të arritur në mes të Prokurorisë së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe të akuzuarit Pashko Ljubiçiq. Në aktakuzën e ndryshuar, e cila ishte objekt i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ka mbetur vetëm një vepër penale, ajo e krimeve të luftës kundër popullsisë civile, e paraparë me nenin 173 paragrafin 1, pikat a) dhe f) të Ligjit Penale të Bosnjë e Hercegovinës.

I akuzuari Ljubiçiq i pranon veprat që i vihen në barrë, prandaj në pikën 27 të Marrëveshjes thuhet: *Gjatë sulmit të bërë më 16 prill të vitit 1993, ushtarët e HVO-së, duke përfshirë edhe pjesëtarët e policisë ushtarake IV nën komandën time, kanë*

*shfrytëzuar përpos tjerash edhe granatat, eksplozivët dhe municionin ndezës, në mënyrë që të kryhet sulmi në pozicionet në Ahmiq. Objektiv i këtyre sulmeve ishin caqet ushtarake, sikurse edhe shtëpitë, objektet e kultit, bagëtia dhe njerëzit.*

Shqyrtimi kryesor filloi më 11.05.2007. Gjithsej janë zhvilluar 29 ditë gjykim në të cilat janë dëgjuar 27 dëshmitarë të prokurorisë, nga të cilët 12 ishin dëshmitarë të mbrojtur identiteti i të cilëve nuk është zbuluar, ndërsa publiku është përjashtuar dy herë gjatë gjykimit.

Gjatë vitit 2008 janë zhvilluar 6 gjykime. Edhe pse mbrojtja kishte paralajmëruar dëgjimin e tre dëshmitarëve, më 21.04.2008 i akuzuari arriti marrëveshje me Prokurorinë e Bosnjë dhe Hercegovinës për pranimin e fajit. Trupi gjykues e pranoi marrëveshjen dhe e shpalli të akuzuarin fajtor. I akuzuari është lënë i lirë deri në dërgimin në vuajtje të dënimit me 10 vite heqje lirie.

Fitohet përshtypja se pranimi i fajit nga i akuzuari nuk është i sinqertë, prandaj, për pasojë, viktimat e krimit nuk kanë marrë satisfaksionin e nevojshëm.

#### **4.4. Rasti Zijad Kurtoviq**

Trupi gjykues i Seksionit të I-rë për krime të luftës i Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës ka shqiptuar vendimin me të cilin i akuzuari Zijad Kurtoviq shpallet fajtor për këto vepra penale: krime të luftës kundër popullsisë civile, krime të luftës kundër robërve të luftës dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës, dhe është dënuar me një dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 11 vitesh.

Zijad Kurtoviq është shpallur fajtor pasi si komandant i çetës së policisë ushtarake të batalionit të pavarur *Drezhnica*, që ka vepruar në përbërje të Armatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, në gjysmën e dytë të vitit 1993, në kishën katolike të Svih Svetih, në Drezhnicën e Poshtme të Mostarit, ka torturuar dhe keqtrajtuar 20 robër të nacionalitetit kroat, duke u shkaktuar atyre lëndime fizike dhe psikike. Gjithashtu, sipas aktakuzës, i akuzuari gjatë të njëjtës periudhë i ka urdhëruar pjesëtarët e mbrojtjes civile që t'i dërgojnë civilët dhe ushtarët e robëruar kroat në frontin e luftës, për t'u përdoren si mburoja të gjalla mes të Armatës së B. e H.-së dhe HVO-s.

Gjykimi ka filluar më 27.08.2007 dhe deri në fund të shqyrtimit kryesor janë mbajtur gjithsej 22 seanca dhe janë dëgjuar 32 dëshmitarë, 2 nga të cilët dëshmitarë të mbrojtur. Gjatë vitit 2008 janë mbajtur 11 ditë gjykim ku janë dëgjuar 15 dëshmitarë të mbrojtjes të cilët janë mundur t'i sigurojnë alibi të akuzuarit për periudhën e fillimit të tetorit të vitit 1993. Gjithashtu, është dëgjuar edhe i akuzuari, i cili e ka mohuar fajësinë.

Përkundër faktit se gjykimi ishte në nivel të lartë profesional, duke i plotësuar parimet e gjykimit korrekt dhe të drejtë, nuk mund të thuhet se vendimi solli drejtësi për viktimat sepse kohëzgjatja e dënimit nuk është proporcionale me peshën e veprave penale të kryera, shkallën e përgjegjësisë penale, qëllimin dhe urrejtjen e shprehur, si dhe gatishmërinë për përsëritjen e veprave të ngjashme. Vërejtja tjetër për vendimin e trupit

gjykues ka të bëjë me mos caktimin e masës së paraburgimit gjatë kohëzgjatjes së procesit si dhe pas shpalljes së dënimit. Është e pazakontë që të mbrohet në liri i akuzuari për krime lufte kundër popullsisë civile, robërve të luftës dhe shkeljes së rëndë të ligjeve dhe zakoneve të luftës.

## **5. Gjykimet për krime të luftës në Kroaci**

### **5.1. Rasti Cerna**

Gjykata e Zhupanisë në Vukovar ka shqiptuar më 14.02.2008 aktgjykimin i cili i dënon gjashtë pjesëtarët e çetës vëzhguese-diversante, dhe atë si vijon: i akuzuari Tomsilav Madija me burgim në kohëzgjatje 20 vite, Maria Juriq me 12 vite, Zoran Poshtiq me 8 vite, Davor Laziq me 7 vite dhe Mija Starçević me burgim në kohëzgjatje prej 10 viteve, për shkak të plaçkitjes dhe vrasjes së çiftit bashkëshortor Olujiq dhe dy fëmijët e tyre të mitur, në shkurt të vitit 1992 në Cernë. Aktakuza është ngritur më 29.12.2006 dhe është ndryshuar më 8.2.2008. Të akuzuarve u është vënë në barrë se kanë kryer veprë penale krime të luftës kundër popullsisë civile, sipas nenit 120 paragrafit 1 OKZ të Republikës së Kroacisë.

Shqyrtimi kryesor para trupit gjykues të kryesuar nga gjykatësi Ante Zeljko<sup>34</sup> filloi më 28.03.2007. Janë zhvilluar gjithsej 40 seanca gjyqësore dhe janë dëgjuar 58 dëshmitarë dhe 8 ekspertë. Gjatë vitit 2008 janë mbajtur gjashtë seanca gjyqësore dhe më këtë rast është dëgjuar një dëshmitar, është urdhëruar ekshumimi i trupit të të ndjerit Stojan Vujnoviq të njohur me nofkën Serbi dhe kryerja e ekspertizës nga Enti për Mjekësi Ligjore në Zagreb, me qëllim që të sigurohet mostra e ADN-së së Vujnoviqit dhe të përcaktohet përputhja eventuale e kësaj mostre me atë që është siguruar nga bishti i cigares *Milde Sorta* e gjetur në vendin e ngjarjes.

Edhe pse ky gjykim duket të jetë efikas për nga numri i provave të paraqitura, është fakt se ai nuk është zhvilluar shpejt. Arsytet për këtë duhet kërkuar në faktin se tre të akuzuarit (Madi, Juriq dhe Starçević) e kanë paraqitur mbrojtjen e tyre për herë të parë gjatë shqyrtimit kryesor, i kanë ndërruar avokatët dhe me këtë është paraqitur nevoja për nxjerrjen e provave të reja dhe shtyrjen e disa seancave të caktuara më parë. Nga ana tjetër, një varg provash kanë mundur të paraqiten gjatë kohës së zhvillimit të hetimeve (ekspertiza e ADN-së, ekshumimi dhe të ngjashme), e jo gjatë shqyrtimit kryesor. Përkundër të metave të konstatuara, mund të përfundohet se ky gjykim është zhvilluar në mënyrë profesionale dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë dhe se të akuzuarve u janë shqiptuar dënimet në përputhje me ligjin.

### **5.2. Rasti Medački xhep**

Më datë 30.05.2008, Gjykata e Zhupanisë në Zagreb ka shpallur aktgjykimin i cili e liron në tërësi të akuzuarin Rrahim Ademi nga të gjitha akuzat, përderisa të akuzuarin tjetër, Mirko Norac, e liron nga akuza se ka urdhëruar sulmin pa zgjedhur objektivat, gjatë të cilit kanë pësuar civilët dhe prona e tyre. Megjithatë, i akuzuari Norac është shpallur

<sup>34</sup> Anëtarë të trupit gjykues ishin gjykatësja Jadranka Kurbel dhe gjykatësja Branka Ratkajec-Çoviq.

fajtor për dy pikat tjera të aktakuzës, për shkak se nuk ka penguar, e me këtë ka përkrahur dhe inkurajuar vrasjen e civilëve dhe plaçkitjen e pronës së tyre dhe ka torturuar robërit e luftës, për çka është dënuar me nga pesë vite heqje lirie. Gjykata i ka bashkuar këto dy dënime në një dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej tetë vjetësh.

Shqyrtimi kryesor ka filluar më 18.06.2007 para trupit gjykues me të cilin udhëhiqte gjykatësi mr. Marin Mrçela<sup>35</sup>. Gjithsej janë zhvilluar 77 ditë gjykim gjatë të cilave janë dëgjuar 66 dëshmitarë dhe dy ekspertë. Prej fillimit të vitit 2008 e deri në shpalljen e vendimit janë mbajtur 31 ditë gjykim, ku janë dëgjuar 33 dëshmitarë, prej të cilëve 12 ishin dëshmitarë të mbrojtur dhe dy ekspertë.

Gjykimi i dy gjeneralëve kroatë për krime lufte kundër civilëve dhe robërve të luftës në Medaçki xhep, të akuzuarve Rrahim Ademiti dhe Mirko Norac, ishte në nivel të lartë profesional sa i përket dinamikës së procesit dhe përmbajtjes së tij. Është fjala për lëndën penale të cilin TNPJ ia dorëzoi për procedim drejtësisë kroate. Prokuroria nuk arriti të dëshmojë se të akuzuarit Ademi dhe Norac kanë pasur komandën ndaj policisë speciale, prandaj shumë viktima civile që u vranë në zonën e përgjegjësisë së policisë speciale nuk u përfshinë në aktgjykimin e shqiptuar. Vendimi i gjykatës nuk e arsyetoi në mënyrë bindëse pse u lirua në tërësi nga fajësia i akuzuari Ademi, kur është e padiskutueshme se urdhrat gojore nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Kroate, para së gjithash urdhrin për sulm e shndërroi në urdhër të shkruar dhe me vetiniciativë dha disa urdhra tjera. Nuk është marrë parasysh fakti se gjatë gjithë kohës së aksionit dhe pas tij, gjeneral Ademi ka qenë prezent në cilësinë e komandantit efektiv të korpusit, ka dhënë dhe ka zbatuar urdhra dhe ka qenë dakord e i vetëdijshëm me ato që kanë ndodhur. Gjykata nuk pranoi se ekzistonte përgjegjësia e të akuzuarit Norac për sulmin pa zgjedhjen e caktimit dhe granatimit e tepruar, edhe pse gjatë procesit është bërë e qartë nga disa dëshmi se është shfrytëzuar një sasi e madhe e municionit artilierik dhe Norac personalisht dha urdhrin që gjatë sulmit të shfrytëzohet katër herë më shumë municion nga ajo që ishte e nevojshme. Deri te një aktgjykim i këtillë ka ardhur pjesërisht për shkak se prokurori ka dështuar ta ndryshojë aktakuzën ashtu që shumë viktima, të cilat sipas aktakuzës kanë pësuar nga granatimi i tepruar, t'i cilësojë si të vrarë drejtpërdrejt nga ana e ushtarëve kroatë pas aksionit, çka tregon edhe rezultati i procedurës së prezantimit të provave. Për këtë arsye, këto viktima nuk kanë qenë pjesë e vendimit për dënim. I akuzuari Norac është dënuar për atë që ka ndodhur në Medaçki xhep prej 10 deri më 17.9.1993, por jo edhe për krimet në ditën e sulmit, më 09.09.1993. Kjo për arsye se trupi gjykues është i mendimit se ai që dështon t'i ndalojë krimet nuk mund të jetë përgjegjës për krimet e kryera në fillim, por për ato që pasojnë më vonë, sepse mendohet që me indolencën e vet ai i ka mbështetur dhe inkurajuar ato. Kjo është e pakuptimtë sepse ai është akuzuar për mos pengimin e mos parandalimit e veprave penale dhe për mosndëshkimin e kryerësve që kanë kryer krime, nga dita e parë deri ditën e fundit të aksionit. Dënimet e shqiptuara të akuzuarit Norac janë minimale duke pasur parasysh veprat penale që i vihen në barrë. Kryetari i trupit gjykues këtë e arsyetoi me faktin se i akuzuari nuk i urdhëroi krimet por vetëm dështoi që t'i pengojë ato, se ai është i dekoruar, se ka qenë shumë *i ri* në kohën e kryerjes së veprës penale (kishte 26 vjet) dhe që atëherë ka kaluar një periudhë e gjatë kohore. Bie në sy se trupi gjykues nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat rënduese

<sup>35</sup> Anëtarë të trupit gjykues ishin gjykatësi Sinisha Pleshe dhe gjykatësja Jasna Pavičić.

dhe për pasojë i akuzuari Norac është dënuar me dënim minimal, përkundër pasojave të rënda të veprave të tij dhe faktit se është dënuar me vendim të plotfuqishëm për krime lufte dhe se sjellja e tij kriminale ishte e veçantë.

Prokuroria është ajo që meriton më së shumti kritika. Gjatë marrjes së aktakuzës nga Tribunali i Hagës, Prokuroria ka lëshuar rastin që të zhvillojë hetime dhe ta sqarojë rolin e të akuzuarve, por edhe të personave tjerë që kanë vepruar si komandantë, para së gjithash admiralin e tanishëm Davor Domazet - Losha, pastaj kolonelin e policisë speciale Zheljko Sashiqin dhe gjeneralin Mladen Markaç. Në vend të kësaj, Prokuroria e ka ngritur menjëherë aktakuzën, duke insistuar se aksioni *Xhepi 93* ishte operacion ushtarak legjitim dhe për këtë arsye i ka zbutur veprat e kryera, duke e akuzuar Ademin dhe Norcin, jo më si urdhërdhënës, por për shkak të lëshimeve në detyrë, respektivisht për mos pengimin e kryerjes së krimeve. Kjo ishte në kundërshtim me dëshmitë e disa dëshmitarëve, oficerë të ushtrisë kroate, të cilët e kanë thënë qartë se qëllimi i aksionit ishte frikësimi dhe largimi i popullsisë serbe dhe fakti se minat anti-tank të përdorura për shkatërrimin e shtëpive janë resurse që kontrollohen rreptë dhe nuk mund të përdoren pa urdhër nga niveli më i lartë. Prokurori i kësaj lënde, Antun Kvakan, në disa situata është sjellë në mënyrë pasive (si për shembull me rastin e propozimit të dëshmitëve, parashtimit të pyetjeve, paraqitjes së vërejtjeve etj.), duke ua lënë iniciativën mbrojtësve të të akuzuarve dhe duke u përpjekur që t'i arrijë qëllimet e aktakuzës përmes kundërthënieve të tyre. Prokuroria nuk ka shprehur interes për zbulimin dhe dënimin e komandantëve tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në kryerjen e krimeve në Medaçki Xhep, edhe pse procedura e paraqitjes së provave ka treguar involvimin e disa personave, respektivisht pjesëtarëve të formacioneve të ndryshme ushtarake. Mbetet përshtypja se drejtësia kroate i ka hyrë gjithë kësaj lënde pa dëshirë, pa vullnetin e vërtetë që ngjarja të ndriçohet dhe kriminelët të dënohen në mënyrë të drejtë.

### **5.3 Rasti Glavash**

Prokuroria Shtetërore e Zhupanisë (PSHZH) në Osjek ka ngritur aktakuzën kundër Branimir Glavashit, Ivica Krnjakut, Gordana Getosh Magdiqit, Mirko Siviqit, Dino Kontiqit, Tihomir Valentiqit dhe Zdravko Dragiqit për veprën penale krime të luftës kundër popullsisë civile, për shkak të vrasjes së nëntë dhe tentim vrasjes së një personi, të gjithë të kombësisë serbe, gjatë nëntorit dhe dhjetorit të vitit 1991. Të akuzuarin Branimir Glavash, PSHZH në Zagreb e akuzoi edhe për një vepër të njëjtë penale për shkak të dhënies së urdhrit apo mos pengimit të kryerjes së vrasjeve, torturimit dhe formave tjera të veprave çnjerëzore ndaj popullsisë civile gjatë periudhës korrik-shtator të vitit 1991, në Osjek. Për të dy aktakuzat është zhvilluar procedurë e përbashkët para Gjykatës së Zhupanisë në Zagreb, e cili filloi më 15.10.2007. Për shkak se i akuzuari Mirko Siviq kishte probleme të vazhdueshme shëndetësore, procedura ndaj tij u nda nga ato të të akuzuarve tjerë, me datë 05.06.2008.

Gjykimin e ka udhëhequr gjykatësi Zheljko Horvatoviq<sup>36</sup>. Në kuadër të shqyrtimit kryesor janë mbajtur 50 seanca gjyqësore në të cilat janë dëgjuar 37 dëshmitarë dhe tre

---

<sup>36</sup> Anëtarë të trupit gjykues janë gjykatësja Rajka Tomerlin Almer dhe gjykatësja Sonja Breshkoviq Balent.

ekspertë. Të gjithë këta janë dëgjuar në vitin 2008, gjatë të cilit janë zhvilluar 38 ditë gjykim.

Gjykata ishte para sfidave që në fillim të gjykimit sepse i akuzuari Branimir Glavash hyri në grevë urie me datë 08.11.2007, që ishte shkas për manipulime mediale me qëllim që i akuzuari të prezantohet si viktimë. Gjatë gjykimit i akuzuari iu drejtua disa herë opinionit duke xhiruar disa video-mesazhe me të cilat iu drejtua zgjedhësve në prag të zgjedhjeve të atëhershme, që është në kundërshtim me rregullat e paraburgimit. Glavashi u zgjedh deputet dhe pas konstituimit të Kuvendit të Kroacisë, në fillim të vitit 2008, ai fitoi imunitet nga ndjekja penale dhe paraburgimi, prandaj organi i Kuvendit për çështjet e mandateve dhe imunitetit ka vendosur që të lejojë vazhdimin e procedurës penale, por nuk e ka miratuar vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim, i cili edhe është ndërprerë dhe prej 11.01.2008 ai mbrohet në liri. Më vonë edhe disa të akuzuar të tjerë janë liruar duke iu falënderuar vendimit të Gjykatës Kushtetues të RK-së, që në kundërshtim me qëndrimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kroacisë vendosi që të akuzuarit nuk mund të mbahen në paraburgim më gjatë se dy vite, duke marrë parasysh të drejtën e tyre që procedura të zhvillohet brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

E meta e vetë procesit qëndron në mënyrë se si udhëhiqej procedurës nga ana e kryetarit të kolegjit gjykues, Zheljko Horvatović, i cili nuk shfrytëzoi në masë të duhur autorizimet e tij ligjore dhe nuk vendosi nivelin e duhur të disiplinës gjatë shqyrtimit kryesor, gjë që mund të ketë ndikuar në përfundimin e procesit. Përpos kësaj, ai ka lejuar që disa herë të akuzuarit të deklarohen për faktet e përmendura në dokumente, të cilat nuk janë pjesë e procesverbalit gjyqësor dhe për të cilat më vonë u mor vesh se ishin të klasifikuar si dokumente sekrete. Gjykata ka dëshmuar se nuk mund t'ia dalë mbanë me manipulimet taktike të avokatëve mbrojtës, të cilët kanë pasur sukses në përpjekjet e tyre që ta zgjasin pa nevojë këtë proces dhe të ndikojnë në përsëritjen e tij për herë të dytë<sup>37</sup>.

Duke pasur parasysh gjithë atë që është thënë më parë, nuk është për t'u çuditur që dëshmitarët jashtë Kroacisë refuzojnë të dëshmojnë në këtë lëndë, me çka edhe më shumë zvogëlohen gjasat që të përcaktohet e vërteta për ngjarjet në Osjek në vitin 1991 dhe roli i të akuzuarve në to.

#### **5.4. Rasti *Gudelj***

Më datë 7 korrik 2008, Gjykata e Zhupanisë në Osjek ka shpallur aktgjykimin me të cilin i akuzuari Antun Gudelj shpallet fajtor për tre vepra penale të vrasjes, ku për secilën prej tyre gjykata i ka shqiptuar nga 20 vjet burgim, dhe një tentim vrasje për të cilën i janë shqiptuar 10 vite burg, kështu që ai u dënua me një dënim unik prej njëzet vjetë heqje lirie.

Me datë 01.07.1991, Antun Gudelj, pjesëtar i përbërjes rezervë të policisë së Republikës së Kroacisë, me detyrë në punktin policor në afërsi të Tenjes, ka hapur zjarr nga largësia

---

<sup>37</sup> Më 5 nëntor 2007, vetëm një muaj pas fillimit të gjykimit, shqyrtimi kryesor **nuk** kishte filluar ende sepse një nga anëtarët e trupit gjykues i plotësoi kushtet për pensionim, gjë që duhej të ishte paraparë shumë më herët.



prej 30 metra në drejtim të veturës së ekipit negociator, e cila po lëvizte nga Osjeku në drejtim të Tenjës. Me këtë rast ka vrarë komandantin e atëhershëm të policisë së Osjekut, Josip Reihla Kira, kryetarin e Këshillit Ekzekutiv të komunës së Osjekut, Goran Zobundzhiu dhe deputetin e Kuvendit të komunës së Osjekut, Milan Knezheviqin, përderisa ka plagosur rëndë kryetarin e Bashkësisë Lokale të Tenjes, Mirko Tubiqin. Menjëherë pas kësaj vepre, Antun Gudelj është larguar nga Kroacia për në Australi, shtetas i së cilës është gjithashtu. Në vitin 1994 është dënuar në mungesë me njëzet vite burgim, por vendimi është shfuqizuar në vitin 1996 kur u ekstradua nga Australia në Kroaci, sepse me këtë u krijuan mundësitë që ai të marrë pjesë në procedurën e përsëritur. Mbrojtësi i të akuzuarit kërkoi që procedura penale ndaj tij të ndërpritet, duke u thirrur në ligjin për amnisti, kërkesë kjo që u hodh poshtë nga Gjykata e Zhupanisë në Osjek, por Gjykata Supreme e Kroacisë (GJSK) duke e shqyrtuar ankesën e mbrojtjes e ndërroi këtë vendim ashtu që miratoi kërkesën për amnisti, ndërpreu procedurën penale dhe e liroi të akuzuarin nga paraburgimi. Me këtë procedura kundër tij u ndërpre në mënyrë të plotfuqishme. Megjithatë, me kërkesë të përfaqësuesit të të dëmtuarës Jadranka Reihl-Kir, Kryeprokurori Publik i Republikës së Kroacisë paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit për amnisti. Gjykata Supreme e Kroacisë në seancën e departamentit penal konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar dhe se është shkelur ligji në favor të të akuzuarit. Përmes përfaqësuesit ligjor, e dëmtuara i drejtoi padi kushtetuese Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë (GJKRK), e cila me vendimin e vet të datës 14.03.2001 e pranoi padinë kushtetuese dhe shfuqizoi vendimin e Gjykatës Supreme të Kroacisë, me çka procedura u ndërpre dhe lënda iu kthye Gjykatës Supreme për rishqyrtim. Me rastin e marrjes së vendimit nga ane e GJKK-së, Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e të akuzuarit dhe e vërtetoi vendimin në bazë të së cilit Gjykata e Zhupanisë së Osjekut e refuzoi kërkesën për amnisti. Me këtë vendim u krijuan kushtet që Antun Gudelj të përgjigjet për veprat penale të cilat i kishte kryer dhe u ekstradua përsëri nga Australia. Ai u arrestua më 15. 07.2007.

Gjykimi filloi më 09.10.2007. Gjithsej u mbajtën 15 ditë gjykim ku u dëgjuan 24 dëshmitarë (ose u lexuan deklaratat e tyre). Gjatë vitit 2008 janë mbajtur 10 ditë gjykim dhe në to janë dëgjuar 10 dëshmitarë dhe janë lexuan katër deklaratat të cilat janë pranuar në vend të dëshmitëve.

Procedura penale është zhvilluar në mënyrë korrekte dhe në përputhje me ligjin. Ka përfunduar me shqiptimin e dënimit maksimal me të cilin ka mundur të dënohet i akuzuari në bazë të ligjit penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale. Rrethanat rënduese që ndikuan në shqiptimin e dënimit më të rëndë ishin se i dëmtuari Josip Reihl Kir është vrarë si person zyrtar, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe se të gjitha vrasjet dhe tentim vrasja janë kryer për shkak të hakmarrjes së panjerëzishme. Gjykata konkludoi, me plotë të drejtë, se nuk kishte dredhi në anën e të akuzuarit, edhe pse prokurori e akuzoi edhe për këtë.

Përkundër shqiptimit të dënimit kaq të rëndë, mbetet përshtypja se procedura as që do të zhvillohej sikur e dëmtuara Jadranka Reihl Kir me përfaqësuesin e autorizuar të mos ishte përfshirë në një betejë ligjore disavjeçare për zbardhjen e të vërtetës. Ata praktikisht ishin të detyruar që gjatë kësaj procedure ta marrin rolin e prokurorit, por edhe rrezikun që

dhuna të drejtohet edhe ndaj tyre, sepse janë sulmuar shpesh në publik. Ata janë përpjekur që përmes pjesëmarrjes në procedurë dhe më gjerë, ta ndriçojnë gjithë ngjarjen dhe ko incidencën e pazakontë se Antun Gudelj e vrau Josip Reihla Kira pikërisht në kohën kur të dëmtuarit dhe një varg i funksionarëve të atëhershëm shtetëror ishin në dijeni se po përgatitej vrasja e tij, kurse është menduar se urdhërdhënësit e mundshëm janë nga HDZ-ja, dhe kur për këtë arsye po planifikohej transferimi i tij në Zagreb. Gjykata e pranoi se i akuzuari Gudelj e kreu vrasjen i revoltuar nga fakti se ishin duke u zhvilluar negociata me serbët nga Tenja, sepse më herët kishte dëgjuar se në atë fshat ia kishin vrarë dhe varur babanë në kishën ortodokse, nënën ia kishin dhunuar dhe vrarë, kurse shtëpinë e prindërve ia kishin shkatërruar me eksploziv. Informatat për vrasjen e prindërve të të akuzuarit ishin të pavërteta dhe mbetet pyetja nëse ai ishte me të vërtetë motivi i vrasjes, kur dihet se Gudelj ndodhej në punktin policor, jo më larg se 500 metra nga shtëpia e prindërve dhe kur vërtetësia e fjalëve të tilla mund të përcaktohej sepse lidhjet telefonike në atë kohë ende funksiononin. Përgjigjet në të gjitha pyetjet që shtrohen nuk ka mundur t'i japë gjykata pa iniciativë nga prokurori, sepse gjykata duhet të sillet brenda normave të përcaktuara. Përndryshe, e dëmtuara dhe përfaqësuesi i saj nuk kanë marrë pjesë vetëm në seancën kur është shpallur aktgjykimi, që është shprehje e qartë e protestës së tyre.